



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve” në Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.as.Dr Valentina Haxhiymeri
2. Prof.as.Dr. Florinda Tarusha

Korrik, 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Arteve", Tiranë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore (KMDP)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr. 397, datë 10/08/2011 "Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional", "Master i Shkencave" dhe "Master i Arteve të Bukura" në Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve të Tiranës", pika 2, "Për hapjen e programit të ciklit të dytë në (c) Pedagogji Muzikore, në përfundim të të cilit lëshohet diploma universitare "Master Profesional" në "Pedagogji Muzikore". (Dokumenti 11/1.1.1. Urdhër i MASH Nr. 397, datë 10.08.2011.pdf)
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër të MASR Urdhër Nr.512, datë 24.10. 2019 "Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve" (Dokumenti 1/1.MP Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi / PM Music Education and Teaching).
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.158, datë 19.09.2018 "Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi", të Universitetit të Arteve" (Dokumenti 1/2. MP Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi / PM Music Education and Teaching).
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i II- të
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Siapas dokumentit (nr.165/ Tabela 4.pdf), PAE/PAK i angazhuar për realizimin e programit të studimit (viti akademik 2021 -2022): - PAE mbulon 2765 orë (70%) të programit të studimit - PAK mbulon 1195 orë (30 %) të programit të studimit
18	Numri i studentëve:	- Për vitin akademik 2021-2022 janë 24 studentë - Për vitin akademik 2020-2021 ishin 27 studentë - Për vitin akademik 2019-2020 ishin 29 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u orientua së pari nga shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit të Arteve (në vijim UA) dhe së dyti sipas aktiviteteve të realizuara sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet UA dhe ASCAL.

Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, i licencuar me *Urdhër të MASR* nr. 397, datë 10/08/2011 “Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional”, “Master i Shkencave” dhe “Master i Arteve të Bukura” në Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve të Tiranës”, pika 2, “Për hapjen e programit të ciklit të dytë në (c) Pedagogji Muzikore, në përfundim të të cilit lëshohet diploma universitare “Master Profesional” në “Pedagogji Muzikore” (*Dokumentimi 11/1.1.1. Urdhër i MASH Nr. 397, datë 10.08.2011.pdf*), dhe riorganizuar me *Urdhër të MASR* Nr.512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve” (*Dokumentimi 1/1.MP Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi / PM Music Education and Teaching*).

Programi i studimit me kohë të plotë Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” i përket ciklit të dytë të studimeve dhe ofrohet me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, me 120 ECTS.

Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet si një prej programeve të studimit në Departamentin e Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore (KMDP), të Fakultetit të Muzikës, së Universitetit të Arteve, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë *Urdhër të MASR* Urdhër Nr.512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve”, ku në përfundim të ciklit të studimit dy vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare “Diplomë Master Profesional” në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”.

Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi

Ky program i ciklit të dytë “*Master Profesional*” përmban gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2021-2022 janë 24 studentë
- Për vitin akademik 2020-2021 ishin 27 studentë
- Për vitin akademik 2019-2020 ishin 29 studentë

Gjithsej të diplomuar 41 studentë

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë nga ana e programit të studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc.Dr. Valentina Haxhiymeri dhe Prof.Asoc. Dr. Florinda Kristo dhe gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga menaxherja teknike e ASCAL Znj. Aleksandra Xhamo.

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve”.
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitet kryesorë të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë marrë nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të dytë me emërtesë Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit, i cili ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të Universitetit të Arteve, etj.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit, të Studentëve, Këshillimit dhe Karrierës, Alumni.
- Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Takim me Përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore
- Vizitë në Sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe në bibliotekë
- Takim përfundimtar me Përgjegjësën e Departamentit

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm.

Nga ana tjetër, si pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, u realizua:

Vëzhgimi i mjediseve

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm vëzhgoi mjediset mësimore që ishin në dispozicion të programit të studimit, si: auditorë, laboratorë të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve dhe literaturës së bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB dhe evidencat është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Më datë 22.05.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/74 Prot., datë 22.05.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 06.06.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 515/2 Prot., datë 05.06.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

Referuar shkresës së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Arteve, Tiranë, me Nr. 316/1 Prot., datë 01.06.2023, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në përgjigje të procesit të rishikimit të përmbajtjes së Draft/Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi me vëmendje të posaçme momentet e diskutueshme të përshkruara në këtë shkresë dhe konkludoi si më poshtë:

1. Përsa i përket sugjerimit/rekomandimit mbi përmbushjen e standardit 1.3, kriteri 4 dhe standardit 1.3/konkluzione, GVJ vlerëson qëndrimin e Institucionit, i cili pranon se do ta ketë parasysh përmbushjen e tyre në të ardhmen.
2. Lidhur me Standardin II.1, kriteri 5, GVJ sqaron se rekomandimi është bazuar kryesisht në shqyrtimin e të dhënave të deklaruara në dokumentin RVB (2022, fq.18), ku specifikisht përshkruhet se: *Lëndët dhe veprimtaritë formuese të parashikuara për formimin psiko-pedagogjik janë:*
 - *Vlerësim në arsim 4 kredite*
 - *Metodologji e mësimdhënies 6 kredite*
 - *Teoritë e të nxënësve dhe menaxhim klase 6 kredite*
 - *Zhvillim kurrikule 4 kredite*

Për këtë rast, GVJ thekson që Institucioni mund të korrigjojë ose të përplotësojë deklarinimin e tij në RVB (2022, fq. 18), Fusha II, standardi 2.1, kriteri 5.

Rekomandimi i GVJ për këtë çështje mbetet i pandryshuar.

3. Përsa i përket Standardit II.3, kriteri 2, GVJ vendosi të ndryshojë pjesërisht konstatimet e tij duke shtuar përmbajtjen, si vijon: *“Në fund të Planit Mësimor gjendet një shënim sqarues lidhur me numrin e krediteve për lëndët me zgjedhje që duhet të fitojë studenti për çdo semestër gjatë dy viteve akademike. Në këtë shënim, respektivisht jepet informacion se “Studenti duhet të zgjedh në total 9 ECTS, prej të cilave 3 në semestrin I-II dhe 6 në semestrin III-IV”.*

GVJ vendosi të mbeten të pandryshuara rekomandimet e tjera referuar përmbushjes në tërësi të Standardit II.3, kriteri 2.

4. Lidhur me Standardin II.3, kriteri 4 dhe Standardin II.3/konkluzione, GVJ vendosi që të mbeten të pandryshuara rekomandimet përkatëse. GVJ nxit Institucionin që të marrë në konsideratë shqyrtimin dhe përmbushjen e këtyre rekomandimeve në të ardhmen.
5. GVJ ka marrë pjesërisht në konsideratë shpjegimet e Institucionit lidhur me standardin II.4, kriteri 2, dhe ka reduktuar nga përmbajtja e RVJ paragrafin në vijim: *“GVJ vëren se ndarja e lëndëve me zgjedhje ka nevojë të qartësohet ose të shoqërohet me informacion shtesë/shënim sqarues në fund të planit mësimor, për të përcaktuar se sa lëndë/kredite ka mundësi studenti që të zgjedhë për çdo semestër me qëllim që të fitojë 9 kredite në përfundim të programit të studimit”.*

GVJ vendosi të mbeten të pandryshuara rekomandimet e tjera lidhur me përmbushjen në tërësi të standardit II.4, kriteri 2 dhe II.4, kriteri 3, dhe II.4/konkluzione.

6. Përsa i përket standardit III.4, kriteri 2, të kontestuar nga Institucioni, në shkresën Nr. 316/1 Prot., datë 01.06.2023, GVJ sqaron se Udhëzimi Nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar, nuk ka lidhje me kriteret e aplikimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve (Master Profesional), por **me përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë (Master i shkencave) dhe të ciklit të tretë, në institucionet e arsimit të lartë.**

Dëshmia e njohjes së një prej gjuhëve të huaja nuk është kriter pranimi për kandidatët të cilët aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimit “Master profesional”, por për ata që aplikojnë në programet “Master i shkencave”. Ligji 80/2015 i AL, Neni 76 “ Për pranimin në programet e ciklit të dytë të studimeve, Pika 4 e tij, përcakton se “Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht...”

GVJ vendosi të mbeten i pandryshuar rekomandimi lidhur me përmbushjen e standardit III.4, kriteri 2.

7. Lidhur me Standardin IV.1 – Konkluzione, GVJ vlerëson komentet e Institucionit të paraqitura në shkresën Nr. 316/1 Prot., datë 01.06.2023, si dhe inkurajon përpjekjet e tij për promovimin e mëtejshëm të personelit akademik dhe rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor/artistik.
8. GVJ merr në konsideratë agumentimin e Institucionit në shkresën përkatëse dhe vendos të ndryshojë vlerësimin për Standardit VI.2, kriteri 1.
9. GVJ vlerëson angazhimin e Institucionit në paraqitjen e të dhënave dhe vendos të marrë parasysh këto komente në vlerësimin e Standardit VI.2, kriteri 4 dhe Standardit VI.2–Konkluzione.

Së fundi, duke vlerësuar si serioz dhe të dobishëm angazhimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Arteve, Tiranë, në procesin e rishikimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, grupi i vlerësimit i uron suksese të mëtejshme në përpjekjen e tij për të përmirësuar cilësinë dhe arritur standardet e dëshiruara.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti i Arteve (UA) në Tiranë është një institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit artistik/shkencor, veprimtarive krijuese artistike dhe profesionale. UA ofron programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. (Neni 9, pika 1, dhe 2 e Statutit të UA, 2021; Dokumenti 12/ I.1.2 Statuti i UART.PDF).</p> <p>Universiteti i Arteve (UA) ofron programe studimi në përputhje me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Ky standard gjen shprehje në Statutin e UA (2021), Neni 7 i tij “Zhvillimi i veprimtarisë”, Pika 2, ku deklarohet se “UA vendos në bazë të mësimdhënies traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore dhe ato evropiane” (fq. 7). (Dokumentu 12/ I.1.2 Statuti i UART.PDF).</p> <p>Sipas Rregullores së UA (2021), Neni 48, Pika 2, shprehet se “UA ofron programe të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite”. (Dokumentu 16/I.1.7. VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master në UA (2021)”, Neni 1 i saj, specifikohet se: <i>Programet e ciklit të dytë të studimeve janë programe universitare të formimit artistik të cilat ofrojnë studime edhe në fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndët e artit pranë institucioneve të arsimit parauniversitar të ciklit të ulët dhe të ciklit të mesëm.</i> (Dokumentu 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë, përfshi edhe programin Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet nga Departamenti i Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore (KMDP) Fakulteti i Muzikës (FM), në</p>

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Universitetin e Arteve (UA). (Neni 1, Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, të shprehur në Statutin e UA, 2021.</p> <p>Sipas Statutit të UA (2021), Neni 4 i tij “Misioni”, deklarohet se “UA ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës, si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/ shkencor; b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; d) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; k) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë dhe qytetërimit; etj”. (Dokumenti Dokumenti 12/ I.1.2 Statuti i UART.PDF).</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 2, deklarohet se “Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, nëpërmjet veprimtarive formuese, teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor dhe atij të sektorit kulturor me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësues të muzikës per Institucionet arsimore parauniversitare, të ciklit të mesëm të ulët. - Mësues/instrukturë për qendrat kulturore private. - Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore <p>Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme torike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dokumentin “Plani strategjik i UA 2018-2025” ku ka shplosur misionin dhe visionin e tij për të ardhmen, si vijon:</p> <p>Misioni: Universiteti i Arteve ka për mision edukimin profesional artistik, realizimin e projekteve artistike dhe shkencore në fushën e muzikës, artit skenik, artit figurativ dhe të aplikuar. Misioni i saj lidhet me formimin artistik duke u mbështetur fort në ruajtjen e traditës së mëparshme si dhe garantimin e nivelit të lartë dhe cilësor në të gjitha fushat ku ky institucion operon.</p> <p>Vizioni: Universiteti i Arteve synon të mbetet qendra më e madhe dhe më cilësore e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit, dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së artit. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin dhe projektet artistike, ajo kërkon të përgatisë jo vetëm artistë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Plotësimi i studimeve në vazhdimësi duke e bërë të mundur për ta, të tre ciklet e formimit universitar. Universiteti i Arteve duhet ta</p>

	<p>shohë edhe më tej vetveten në kuadrin e një perspektive të gjerë ndërkombëtare duke shpalosur individualitetin e vet në gjuhë dhe kulturë. (Dokumenti 15/I.1.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UA (2018-2025), në zbatim të Statutit të UA, Neni 99, 100, 101 dhe 102 (Dokumenti Dokumenti 12/ I.1.2 Statuti i UART.PDF), dhe Rregullores së Universitetit të Arteve, Neni 62, 63, 64 dhe 65 (Dokumenti 16/ I.1.7. VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.pdf) si dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit të përcaktuara sipas VKM-së nr. 234, datë 23.3.2011, “Për krijimin e Universitetit të Arteve (Dokumenti 4/Evidenca 1. VKM Nr. 234 date 23.03.2011 Për Krijimin e Universitetit të Arteve.pdf) dhe VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021, Pika 1 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve (në vijim, UART), si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve, krijuar me vendimin nr.234, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Universitetit të Arteve” (Dokumenti 32/II.1.2.VKM NR_ 145 DATE 10_3_2021 Statusi i Veçantë.pdf).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> <p>Referuar RVB (2022) për kriterin 4, mësohet se Programi i studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi mbështetet në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Arteve, Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020, në disa parashikime të Draft Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, sikurse dhe në guidën e UNESCO për arsimin Unpacking Sustainable Development Goal 4 Education 2030. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Plani strategjik i Universitetit të Arteve 2018-2025”, Pika 1.1, institucioni thekson se “<i>Vizioni ynë strategjik është integrimi de jure rajonal, evropian dhe global, duke çuar më tej atë traditë që de facto e bën Universitetin e Arteve një nga IAL-të shqiptare konkurrenente me produktin e saj në tregun evropian dhe botëror. Universiteti i Arteve do të mbështetet gjithnjë e më tepër në tre boshte kryesore të cilët janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Edukimi - Krijimtaria artistike dhe kërkimi shkencor - Produksioni artistik dhe menaxhimi i tij

	<p><i>Universiteti i Arteve operon në një treg global, duke konkurruar brenda vetes dhe brenda vendit për t'i shërbyer atyre që duan të shkollohen në Shqipëri si dhe duke plotësuar të gjitha nevojat e tregut të shkollimit artistik me afrimin e politikave konkurruese me tregun vendas dhe me atë të huaj. Universiteti i Arteve do të punojë për të ndërtuar dhe zgjeruar edhe më tej fushën e veprimtarisë së saj, në mënyrë që të ofrojë mundësinë e zgjedhjes për të gjithë ata që kanë talentin dhe dëshirën për të studiuar dhe thelluar studimet në fushën e artit". (Dokumenti 15/I.1.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf).</i></p> <p><i>Sipas dokumentit "Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" (2022)", Neni 1, deklarohet se "Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizuar për t'ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësime në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm dhe të ulët. Programi i studimit Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi" është hartuar në përputhje me nivelin 7 (shtatë) sipas Nivelit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)". Neni 2 i këtij dokumenti specifikon se "Ky program synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme torike dhe aftësitë e duhura praktike për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arrijeve artistike të vetë studentëve. Plani mësimor i këtij programi studimi zhvillohet në vazhdimësi të programit të Ciklit I (Bachelor) në Pedagogji muzikore dhe, në aspektin përmbajtësor, është strukturuar në mënyrë të tillë që të krijojë mundësinë e lidhjes logjike mes lëndëve përbërëse. Njëherazi, programet e lëndëve sikurse dhe vetë planimësimor, janë hartuar në ngjashmëri me të njëjtat lëndë në vendet e zhvilluara, kryesisht, të Evropës Perëndimore". (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</i></p>								
Konkluzione	<p>UA/FM ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="542 1444 742 1534">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="742 1444 941 1534">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="941 1444 1165 1534">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1165 1444 1410 1534">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="542 1534 742 1572"></td> <td data-bbox="742 1534 941 1572"></td> <td data-bbox="941 1534 1165 1572"></td> <td data-bbox="1165 1534 1410 1572" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën</p>	<p>Universiteti i Arteve Tiranë (UART) përfshin në trashëgiminë e vetë të vyer, eksperiencën e shkëlqyer të Konservatorit të Muzikës të krijuar në vitin 1962, Institutit të Arteve të Bukura të krijuar në vitin 1959, Shkollës</p>

akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

së Teatrit të krijuar në vitin 1959, të cilat së bashku krijuan Institutin e Lartë të Arteve në 1966, dhe që më pas, në viti 1991, u riemërua Akademia e Arteve, dhe prej vitit 2011 e deri më sot, ai emërtohet Universiteti i Arteve. UART përmbledh një tërësi vlerash artistike, kulturore, akademike dhe shoqërore, të krijuara dhe formësuara prej një kohe të gjatë dhe prej një mori brezash të njëpasnjëshëm të pedagogëve, studentëve, artistëve dhe personaliteteve nga më të shquarat në Shqipëri. (Dokumenti 12/ I.1.2 Statuti i UART.PDF, fq. 4).

Universiteti i Arteve përfaqëson një strukturë të integruar të përbërë nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë, si më poshtë:

- Fakulteti i Muzikës
- Fakulteti i Artit Skenik
- Fakulteti i Arteve të Bukura

Fakulteti i Muzikës (FM) përbëhet nga 3 departamente:

- Departamenti Interpretimit
- Departamenti Kanto
- Departamenti Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP)

(Neni 11, Pika 4, Dokumenti 12/ I.1.2 Statuti i UART.PDF, fq. 9).

Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP) në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART).

(Neni 1, Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).

Fakulteti i Muzikës (FM) dhe Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP) dëshmojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit.

Referuar të dhënave në tabelën përkatëse për Personelin Akademik me kohë të plotë, viti akademik 2021-2022 (Dokumenti I.2.1 Organika e FM.pdf; Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf), mësohet se FM ka gjithsej **152 personel akademik**, nga të cilët **84 Personel Akademik Efektiv (PAE)**, me nivel kualifikimi si më poshtë:

- 17 Prof. /Prof. Dr.
- 17 Prof. Asoc. Dr.
- 13 Dr. / Doc.
- 37 Msc.

dhe **68 Personel Akademik me Kontratë (PAK)** me nivel kualifikimi si më poshtë:

- 7 Prof. /Prof. Dr.
- 1 Prof. Asoc. Dr.
- 6 Dr. / Doc.

	<p>- 54 Msc.</p> <p>Raporti midis PAE dhe PAK është 84 (55.3%) me 68 (44.7%), në favor të PAE.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP) i cili ka në përgjegjësi realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, ka gjithësej 48 personel akademik, për vitin akademik 2021-2022, ku 25 PAE, nga të cilët 5 Prof. /Prof.Dr., 4 Prof.Asoc.Dr., 3 Dr./Doc, dhe 13 Msc si dhe 23 PAK, nga të cilët 5 Prof. /Prof.Dr., 5 Dr./Doc dhe 13 Msc. (<i>Dokumenti 43/II.2.1.Personeli Akademik me Kohë të Plotë Njësi Bazë KMDP.pdf; Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategorija: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë për programin MP në Kitarë dhe Mësuesi</i>).</p> <p>Raporti midis PAE dhe PAK është 25 (52%) me 23 (48%), në favor të PAE.</p> <p>Referuar të dhënave për mbulimin e ngarkesës mësimore, nga personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar për realizimin e të programit të studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, për vitin akademik 2021-2022, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE mbulon 2765 orë (69.9% /gati 70%) - PAK mbulon 1195 orë (30.1%) <p>(Dokumenti 165/ Tabela 4.pdf)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 1, shprehet se Fakulteti i Muzikës (FM) është njësi kryesore e Universitetit të Arteve Tiranë (UART) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike – kërkimore – shkencore në fushën e Muzikës. Në Nenin 4, pika 1 të këtij dokumenti, përcaktohet se “<i>FM ka për qëllim kryesor organizimin e procesit të mësimdhënies, dhe artistik/ shkencor, si kurse dhe zhvillimin dhe përhapjen në nivele më të larta intelektuale, të dijës në fushën e Muzikës</i>”. Ndërsa, në pikën 5 specifikohet se “<i>FM kujdeset për cilësinë e mësimdhënies në arsimin e lartë në të gjitha ciklet dhe nivelet e parashikuara me ligj, vepron në fushën e formimit artistik, kulturor/shkencor dhe profesional dhe synon gjithashtu formimin dhe aftësimin e personelit të tij</i>”. Në Nenin 21 të Rregullores përcaktohet se “<i>FM ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve (në vijim, UART), si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve në RSH. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të</i></p>

	<p><i>Krediteve (ECTS)</i>". Në nenin 26, pika 4 e Rregullores, deklarohet se "Programet e studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" u ofrojnë të diplomuarve me një diplomë universitare së paku "Bachelor" arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Këto programe realizohen me 120 kredite dhe zgjatja e tyre normale është 2 vite akademike, në përfundim lëshohet diploma "Master Profesional". (Dokumenti 17/ 1.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), FM kryen veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore artistike-shkencore në fushën kryesore të Arteve dhe Shkencave Humane (kodi 02), atë të përgjithshme Arte (kodi 021) dhe fushën specifike Muzikë dhe Arte Performuese (kodi 0215). Njëherazi veprimtaria mësimdhënëse në FM, qëkurse programet e studimit Master janë riorganizuar (shih Evidencë I.1.10) ofrohen në fushën e Edukimit (kodi 01) dhe atë specifike të formimit të mësuesve me specializim të veçantë (kodi 0114). (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP) në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizuar për t'ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm të ulët. Programi i studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" është hartuar në përputhje me nivelin 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. (Neni 1, Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në RVB (2022) raportohet se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit studimi janë në përputhje me Kodin e Cilësisë së AL (1), si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit "Master Profesional; Manualit për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të IAL dhe programeve të studimit 2017 (2); si dhe Udhëzuesit dhe Standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (European Standards and Guidelines-ESG 2015). (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FM, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të Departamentit të Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP), pranë Fakultetit të Muzikës (2022), Neni 1, shprehet</p>

<p>të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>se <i>“Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP) është një nga njësitë bazë të Fakultetit të Muzikës (FM) në Universitetit të Arteve Tiranë (UART) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike – kërkimore – shkencore në fushën e Muzikës”</i>. (Dokumenti 23/I.2.3. 2022_VSA_44.pdf).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP), në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizur për t’ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm të ulët. (Neni 1, Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Përsa më lart, fusha e përgjithshme e programit të studimit të marrë në vlerësim është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP), i cili është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet pjesërisht brenda profilit specifik të IAL-së, duke iu referuar Statusit të veçantë që gëzon Universiteti i Arteve, dhe për rrjedhojë Fakulteti i Muzikës, Departamenti Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP), të cilët janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim. (VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH; Dokumenti 33/II.1.2.VKM NR_145 DATE 10_3_2021 Statusi i Veçantë.pdf).</p> <p>Sipas Statutit (2021), Neni 9, pika 1, deklarohet se <i>“Universiteti i Arteve (UA) në Tiranë është një institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit artistik/shkencor, veprimtarive krijuese artistike dhe profesionale”</i>. (Dokumenti 12/I.1.2 Statuti i UART.PDF).</p> <p>Referuar dokumentit <i>“Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës”</i> (2021), Neni 21 <i>“Programet e studimit”</i>, Pika 1, shprehet se <i>“Fakulteti i Muzikës ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH”</i>. Neni 26 i kësaj rregulloreje, pika 1, shprehet se <i>“Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë, në Master Profesional në</i></p>

Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (Dokumenti 17/I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).

Fillimisht, programi i studimit është ofruar nga UA/FN vetëm në profilin Master Profesional në “Pedagogji Muzikore”, me 90 kredite dhe kohëzgjatje normale 1,5 vite akademike (një vitë e gjysmë) (Dokumenti 11/I.1.1. Urdhër i MASH Nr. 397, datë 10.08.2011.pdf). Në vitin 2019, me Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve”, dhe Urdhër Nr.159, datë 19.09.2018 “Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, të Universitetit të Arteve”, programi i studimit i marrë në vlerësim u riorganizua në Master Profesional me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), si dhe përfshiu në emërtim edhe fushën e Mësuesisë, duke cilësuar formën e regjistrimit të diplomës “Master Profesional” në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi. (Dokumente të kategorisë: Study Programs/ Urdhër Nr.512, datë 2019-10-24; Urdhër Nr.158, datë 2018-09-19).

Sipas institucionit, një nga arsyet për riorganizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, është “krijimi i vështirësive për pranimin e të diplomuarve të sipërpërmendur në tregun e punës” (Dokumenti 60/ II.5.2 relacion i KMDP për riorganizimin e prog MP.pdf, fq. 1), si rezultat i reformave ligjore dhe dispozitave shoqëruese të cilat kushtëzojnë aplikantët t’i nënshtrohen procedurave për mësues si një profesion të rregulluar me ligj. Më tej në këtë dokument, sqarohet se “Në propozimin e FM janë reflektuar ndryshimet sipas vlerësimit të grupeve të punës ku diplomës i është shtuar “ dhe mësuesi”, ndërkohë që plani mësimor është pasuruar me lëndë të karakterit psiko-pedagogjik, totali i të cilave në kredite (ETCS), është 25%.” (Dokumenti 60/ II.5.2 relacion i KMDP për riorganizimin e prog MP.pdf, fq. 2).

Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 1, përcaktohet se “Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, nga Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP), në Fakultetin e Muzikës (FM), të Universitetit të Arteve Tiranë (UART). Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizur për t’ju përgjigjur sa më mire nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm të ulët”. (Neni 1, Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).

	<p>Për të garantuar cilësinë e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji dhe Mësuesi, UA/FM/ KMDP dëshmon se ka rekrutuar PAE dhe PAK të kualifikuar në fushën e psiko-pedagogjisë / mësuesisë, si dhe ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sikurse DAR/ZAV në disa rrethe të vendit për të realizuar praktikat profesionale të studentëve. (Dokumenti 82/III.1.7 CV me trajnimet e stafit akademik.pdf; Kategoria: Vizita dy ditore në institucion dhe dokumentacioni shtesë, Dokumenti 3/1. UART në Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.pdf; Dokumenti 4/ 1.1 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.pdf; Dokumenti 5/2. Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën sos.pdf; Dokumenti 6/ 2.1 zhvillimi i praktikës me Bashkinë Tirane.pdf).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në RVB (2022), institucioni deklaron se “Aktualisht, Universiteti i Arteve për vetë specifikën e tij dhe të fushës që operon, nuk ofron trajnime profesionale apo programe studimi të formimit të vazhduar. Gjithsesi, UART dhe Fakulteti i Muzikës, parashikon zhvillimin e trajnimeve për mësuesit e muzikës dhe lëndët që lidhen me fushën përkatëse sikurse dhe trajnim për aftësimin në teknologjinë e muzikës. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf). ASCAP me shkresën Nr. 555/17.prot datë 30.05.2022, ka akredituar trajnimet sipas modulit “Mësimdhënia e muzikës për nxënësit me aftësi ndryshe”. Trajnimi sipas modulit të sipërpërmendur do të hapet në vitin e ardhshëm akademik. (Dokumenti 24/L.2.4 Trajnimet.pdf).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi është pjesërisht në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Muzikës dhe Departamentin e Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore (KMDP, përgjegjës për programin e studimit të ofruar në institucionin e AL, UART. Por, për të garantuar cilësinë e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, UA/FM/KMDP dëshmon se ka rekrutuar PAE dhe PAK të kualifikuar në fushën e psiko-pedagogjisë / mësuesisë, si dhe ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, sikurse DAR/ZAV në disa rrethe të vendit për të realizuar praktikat profesionale të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UA/FM/KMDP demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UA (2021), dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”.</p> <p>Në Statutin e UA (2021), Neni 1, përcaktohet se “Ky statut ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Arteve, strukturave përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrative dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e UA-së”. (Dokumenti 12/I.1.2 Statuti i UART.PDF).</p> <p>Nga Statuti i UA (2021) buron Rregulloren e Universitetit të Arteve (2021) e cila në Nenin 2, përshkruan se “Qëllimi i kësaj Rregullore është të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullor, të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore, artistike/kërkimore -shkencore dhe administrative të fakulteteve dhe njësisve të tjera përbërëse të UA-së”. (Dokumenti 16/I.1.7. VSA Nr.20 dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Bazuar në këto dokumente kyçe të funksionimit në nivel institucional, janë gjeneruar dokumentet e tjera rregullore në nivel universiteti, fakulteti, departamenti, programi studimor, etj., si: Kodi i Etikës, Rregullore e NJSBC, Rregullore e bibliotekës, Rregullore e sekretaries mësimore, Rregullore e fakultetit, Rregullore e departamentit, Rregullore e programit të studimit, etj., të cilat përbëjnë themelin për të siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (Referuar tërësisë së dokumenteve rregullatore të UA/FM/KMDP, Urdhrave dhe akteve të tjera administrative, të pasqyruara në e-ASCAL për qëllime akreditimi).</p> <p>Në bazë të përcaktimeve të Statutit të UART dhe Rregulloreve përkatëse, në përfundim të çdo viti akademik realizohen analizat vjetore të punës mes njësisve dhe personelit. Raporti Analizës Vjetore (2021-2022) i Departamentit të KMDP, drejtuar Dekanit të Fakultetit të Muzikës, përbën një praktikë të mirë pune dhe është një tregues i bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive, dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (Dokumenti 51/ II.3.5. Raporti vjetor KMDP.pdf; Dokumenti 60/II.5.2 relacioni i KMDP per riorganizimin e prog MP.pdf).</p>

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në Statutin e Universitetit të Arteve (2021), Neni 6, shprehet se “UA ka të drejtën ... (c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas dhe të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, artistike-kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme; (e) për të vendosur marrëdhënie me institucione e organizata vendase apo të huaja, publike dhe jo publike, me organizata biznesi, OJF, etj., lidhur me bashkëpunimin institucional, artistik, profesional e shkencor, për shkëmbimin e përvojave, të personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe të studentëve, për praktikat e studentëve, projekte të përbashkëta, etj..” (Dokumenti 12/I.1.2 Statuti i UART.PDF)</p> <p>Përmes akt-marrëveshjeve dhe dokumenteve të tjera bashkëpunuese ndërinsticionale, UA/FM dëshmon se për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me aktorë të biznesit vendës dhe institucione arsimore që mbështesin realizimin e praktikave profesionale. (Dokumenti 28/I.3.4 Marrëveshje bashkëpunimi.pdf; Dokumenti 29/I.3.5.Nenshkrim marrëveshje praktika mesimore.pdf).</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaron se “Universitetet, Akademitë apo Konservatorët me të cilat bashkëpunon Universiteti i Arteve janë të shumtë në numër. Disa nga këto marrëveshje janë: Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Conservatoire national supérieur de musique et de danse de Paris dhe Universitetit të Arteve; Marrëveshje Kuadër ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim; Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet UART dhe Festivalit të Filmit në Shkup CINEDAYS; Memorandum Mirëkuptimi midis Zhejiang Normal University in Jinhua, Zhejiang, China; Protokoll i Bashkëpunimit të Universitetit të Arteve të Bukura “Mimar Sinan” dhe Universitetit të Arteve, Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës; Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër; Shkollën kombëtare artistike “Jordan Misja”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, UA/FM/KMDP dëshmon se ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione të fushës përkatëse në sistemin arsimor, për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e temave kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. (Dokumenti 29/I.3.5.Nenshkrim marrëveshje praktika mesimore.pdf; Dokumenti</p>

<p>kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>30/I.3.6. <i>Relacion mbi praktiken mesimore per vitin akademik 2021-2022.pdf</i>).</p> <p>Në RVB (2022), institucioni raporton se “<i>për zhvillimin e praktikave mesimore, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi midis Fakultetit të Muzikës dhe Drejtorisë Arsimore të zyrës vendore, qarku Tiranë</i>”/ (<i>Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf</i>).</p> <p>Për të siguruar mbarëvajtjen e praktikave profesionale në shkollë, në përputhje me legjislacionit në fuqi, Universiteti i Arteve dëshmon se ka paguar siguracionet shoqërore për çdo student pjesëmarrës në praktikën profesionale. (Dokumenti 31/I.3.7 Lista e pagesave te studenteve per PM.pdf).</p> <p>Vitet e fundit, UART ka nënshkruar disa marrëveshje partneriteti në kuadër të projektit Erasmus+ mbështetur financiarisht nga BE, të cilat mundësojnë mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik me kohë të plotë. (<i>Dokumenti 27/I.3.3 Erasmus.pdf</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se në të ardhmen institucioni synon që të zgjerojë bashkëpunimet në kuadër të projekteve Erasmus+ me qëllim krijimin e mundësisë së bursave Erasmus+ për studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP), njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, dëshmon se harton raporte për realizimin e praktikës profesionale, duke përfshirë edhe përmbushjen e detyrimeve të shkollës sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë kuadër. <i>Dokumenti 30/I.3.6. Relacion mbi praktiken mesimore per vitin akademik 2021-2022.pdf</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se megjithëse nuk ka raportime analitike periodike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit në tërësi, Departamenti KMDP diskuton rreth mbarëvajtjes së bashkëpunimeve, rast pas rasti, sikurse bashkëpunimet në kuadër të praktikave profesionale, si dhe analizon rezultatet e tyre gjatë mbledhjes së analizës vjetore.</p> <p>Lidhur me këtë kriter, <i>GVJ i sugjeron</i> njësisë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit, që të <i>forcojë praktikën e mirë të raportimit periodik jo vetëm për mbarëvajtjen e praktikës profesionale, por edhe për përfitimet nga bashkëpunimet me aktorë, institucione dhe organizma të tjerë, brenda dhe jashtë vendit.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UART/FM/ KMDP dëshmon se ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, organizata, aktorë të biznesit, vendase dhe të huaja në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. GVJ sugjeron që Departamenti KMDP të <i>forcojë praktikën e mirë të raportimit periodik, jo vetëm për mbarëvajtjen e praktikës profesionale, por edhe për përfitimet</i></p>

	<i>nga bashkëpunimet me aktorë, institucione dhe organizma të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet shtesë	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet shtesë	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, “Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, përcakton se “Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</p> <p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, dhe i ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Pika 2 e tij, shprehet se: <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</i></p> <p>a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</p> <p>c) rezultatet e të nxënit (objektivat formues) dhe kompetencat profesionale;</p> <p>ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</p> <p>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</p> <p>dh) planin mësimor;</p> <p>e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</p> <p>ë) programin lëndor (Syllabus-et);</p> <p>f) profilin e programit;</p>

XB *12*

g) diplomën dhe suplementin

VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar, Pika 2.4/a “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, përcakton se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:

- i. mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;
- ii. studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
- iii. përgatitje për provime;
- iv. përgatitje e tezës së diplomës;
- v. veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private;

(Dokumenti 34/II.1.3.VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.pdf).

Në dokumentin “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës” (2021), Neni 21 “Programet e studimit”, pika 1 dhe 2, shprehen se:

1. Fakulteti i Muzikës ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH.
2. Programet e studimit të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.

Neni 26 i kësaj rregullore, pika 1, shprehet se “Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuësive” (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).

Sipas dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 5 i tij “Veprimtaritë formuese të programit të studimit”, përcakton se:

- 1) Në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime),

	<p>studimit individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh artistike dhe shkencore, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës), praktikave profesionale, etj..</p> <p>2) Në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, veprimtaritë formuese grupohen mbi bazë të objektivave në përuthje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar.</p> <p>3) Shpërndarja e krediteve sipas aktiviteteve formuese brenda një disipline përcaktohet nga Departamenti KMDP, në funksion të natyrës së saj dhe është e shprehur në planin mësimor të këtij programi.</p> <p>Neni 6 i Rregullores “Për organizimin e programit të studimit” përcakton se: Programi i studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi mbështetet në dokumentacionin themelor të tij që janë:</p> <p>a) Plani mësimor b) Programet mësimore të disiplinave përbërëse c) Rregullorja mësimore e programit të studimit</p> <p>Neni 7 i Rregullores përshkruan se: Programi i studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi përmban një strukturë mësimore të grupuar si më poshtë:</p> <p>a) Lëndë bazë b) Lëndë karakterizuese c) Lëndë ndërdisiplinore/ integruese d) Lëndë plotësuese</p> <p>(Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Referuar dokumentit “Plani Mësimor (2021-2022)” të programit të studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi , konstatohet se lëndët/modulet janë grupuar në kategori si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (12 ECTS) - LËNDË KARAKTERIZUESE - përgatitje për disiplinën shkencore - artistike (45 ECTS) - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (18 ECTS) - LËNDË ME ZGJEDHJE (9 ECTS) - LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale (12 ECTS) - DETYRIME PËRMBYLLËSE (24 ECTS) <p>(Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Të dhënat e paraqitura në Planin Mësimor (2021-2022), janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018 (i ndryshuar), për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të</p>
--	---

ciklit të dytë Master Profesional, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018, (% e krediteve)	Të dhënat në Planin Mësimor "MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi"	
			ETCS	%
A	Lëndë bazë	5%-10%	12	10%
B	Lëndë karakterizuese	30%-40%	45	37.5%
C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	20%-30%	27	22.5%
D	Lëndë plotësuese	10%	12	10%
E	Detyrime përmblylëse	10%-20%	24	20%
			120	100%

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në dokumentin "Planin Mësimor 2021-2022", me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, i ndryshuar Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë Master Profesional, dëshmon se elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" (2022), Neni 2, deklarohet se "Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi", nëpërmjet aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor dhe atij të sektorit të kulturës me:


- Mësues të muzikës për institucionet arsimore parauniversitare, të ciklit të mesëm të ulët.
- Mësues/instrukturë për qendrat kulturore private.
- Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore

Ky Program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. Plani mësimor i këtij programi studimi zhvillohet në vazhdimësi të programit të Ciklit I (Bachelor) në Pedagogji Muzikore dhe, në aspektin përmbajtësor, është strukturuar në mënyrë të tillë që të

	<p>krijojë mundësinë e lidhjes logjike mes lëndëve përbërëse”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin e marrë në vlerësim, janë përshkruar në Nenin 8 të kësaj Rregullore, ku deklarohet se “ <i>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” pajis studentin me njohuri të thelluara mbi pedagogjinë në përgjithësi dhe atë muzikore në veçanti. Përpos lëndëve që mbështesin formimin teorik dhe praktik të studentit, lëndët kryesore të këtij programi, orientojnë studentët drejt teknikave bashkëkohore të mësimdhënies në fushën e muzikës duke i pajisur me kulturë muzikore dhe interpretative. Nisur nga vetë specifika e programit të studimit, aftësimi dhe kompetencat e zhvilluara janë individuale për çdo student në varësi të estetikës personale dhe prirjeve të vetë studentit. Studentët e programit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” zhvillojnë kapacitetet e tyre në fushën e mësimdhënies. Ata marrin një formim muzikor të gjithanshëm për të dhënë kulturë muzikore në insitucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Studentët aftësohen t’u mësojnë fëmijëve materiale muzikore nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ata kanë kompetencën për të dhënë mësimë muzike me një instrument muzikor. Futja e disa lëndëve të reja muzikore si Pop, Jazz, muzikë filmi etj., i ka dhënë një frymëmarrje dhe diapozon më të gjerë formimit muzikor të studentëve të Masterit Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”. Praktikrat mësimore i japin mundësinë studentëve të mësojnë dhe zbatojnë në praktikë atë çfarë kanë mësuar në orët teorike dhe praktike në auditore. Aftësohen për të qenë të gatshëm për të menaxhuar dhe drejtuar procesin mësimor”.</i> (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Lidhur me kriterin 2, në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet se programi i studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi ka deklaruar qartë në dokumentet e tij rregullatore se synon formimin e shprehive të veçanta në një lami profesionesh e specialitetesh që ndërthurin edhe përdorimin enjë instrumenti muzikor dhe mësimdhënien e gjinive muzikore të ndryshme në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Gjithashtu, programi jep njohuri të përparuara në fushën e pedagogjisë muzikore dhe nëpërmjet lidhjes së teorisë me praktikën, përgatit studentin për punësim në institucione të arsimit dhe kulturës, zhvillon të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në fushën përkatëse akademike dhe profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e specializuar të studimit dhe atë profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës</p>	<p>Referuar dokumentit “Plani Mësimor (2021-2022)”, konstatohet se Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe</p>

<p>profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Mësuesi ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse, si më poshtë:</p> <p>Praktika profesionale përfshin praktikën mësimore (6 kredite/150 orë mësimore/5% nga totali i krediteve të programit të studimit) dhe rezultojnë e përfshirë në kategorinë D (përkrahë lëndëve të tjera plotësuese). Orët mësimore të praktikës mësimore janë llogaritur gabimisht në kolonën “Orë pune individuale”, në vend të kolonës “Orë mësimore në auditor”. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), praktikat mësimore janë parashikuar me 3 kredite (ECTS) për çdo vit akademik dhe zhvillohen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, të ciklit të mesëm të ulët. Në funksion të zhvillimit të praktikave mësimore Fakulteti i Muzikës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me DAR ose shkollën përkatëse. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Në Planin Mësimor 2021-2022, janë përcaktuar qartë edhe detyrimet përmbyllëse (diploma), të cilës i janë akorduar 24 kredite/600 orë/ 20% nga totali i krediteve të programit të studimit. Diploma është përfshirë në kategorinë E dhe kreditet e akorduara rezultojnë në përputhje me përcaktimet e VKM-së Nr. 41/2018, për këtë kategori (10%-20%). (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Tema e diplomës në programin e studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi realizohet nëpërmjet paraqitjes së punimit teorik (diploma). (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësues i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Referuar dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Neni 2, përshkruhet se “... Plani mësimor i këtij programi studimi zhvillohet në vazhdimësi të programit të Ciklit I (Bachelor) në Pedagogji muzikore dhe, në aspektin përmbajtësor, është strukturuar në mënyrë të tillë që të krijojë mundësinë e lidhjes logjike mes lëndëve përbërëse”. Neni 8 i kësaj Rregullore përcakton se “Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” pajis studentin me njohuri të thelluara mbi pedagogjinë në përgjithësi dhe atë muzikore në veçanti”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaron se “studentët e programit të studimit, pasi kanë marrë aftësitë bazike në lëndët e fushës së muzikës dhe të mësimdhënies e të kulturës së përgjithshme, në Ciklin II kanë mundësinë të thellojnë formimin e tyre teorik në lëndët në drejtimin psiko-pedagogjik dhe atë artistik. Programet e studimit në ciklin e dytë janë programe universitare të formimit artistik por kryesisht ato ofrojnë studime të thelluara në fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim, si mësimdhënës në lëndët e artit, pranë</p>

	<p>institucioneve të arsimit parauniversitar në sektorin publik dhe privat”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi formojnë mësues të artit/muzikës të arsimit të mesëm të ulët dhe është organizuar si program i ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushës përkatëse të formimit.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës</i>” (2021), Neni 26, pika 1 dhe 4, shprehet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë, në...Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi.</i> - <i>Programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” u ofrojnë të diplomuarve me një diplomë universitare së paku “Bachelor”, arsimim dhe trajnim të mëtëjshëm profesional. Këto programe realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është 2 vite akademike, në përfundim lëshohet diplomë Master Profesional.”</i> <p>(Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), lëndët dhe veprimtaritë formuese të parashikuara për formimin e përgjithshëm psiko-pedagogjik në programin e studimit të marrë në vlerësim, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi në arsim (4 kredite) – <i>kategoria A</i> - Metodologjia e mësimitdhënies (6 kredite) – <i>kategoria C</i> - Teoritë e të nxënies dhe menaxhim klase (6 kredite) – <i>kategoria B</i> - Zhvillim kurrikule (4 kredite) – <i>kategoria A</i> <p>(Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Referuar Planit Mësimor 2021-2022, vërehet se gjendet edhe një lëndë e formimit të përgjithshëm psikologjik e përfshirë në programin e studimit, si: Psikologji zhvillimi (4 kredite) – <i>kategoria A</i>. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf)</p> <p>Numri total i krediteve për formimin e përgjithshëm psiko-pedagogjik në programin e studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi shkon 24 kredite/20% nga 30 kredite/25% të krediteve që duhet të përmbajë programi i studimit MP në fushën e mësuesisë, sipas Ligji 80/2015 për AL dhe kriterit 5 të këtij standardi.</p> <p>GVJ rekomandon që të shtohet numri i krediteve dedikuar grup-lëndëve të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik në programin e studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në pajtim me Ligji 80/2015 për AL, Nenin 83 “<i>Programet e studimit në fushën e mësuesisë</i>”, pika 3, që përcakton se “<i>Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e</i></p>



	<p><i>mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik</i>.</p> <p>Në këtë kuadër, institucioni mund të konsiderojë përfshirjen e një lënde me karakter të përgjithshëm psiko-pedagogjik, në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.</p> <p>Lidhur me pikën 4, të Nenit 83 të Ligjit 80/2015, i cili përcakton se “Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme”, institucioni deklaron se “në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ka programe të ngjashme me programin e studimit Master Profesional në Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se “Universiteti i Arteve është institucion i vetëm i arsimit të lartë publik, i cili ofron programe studime Master Profesional për një disiplinë Artistike dhe Mësuesi. Si i tillë, nuk mund të aplikohet kërkesa e dytë e këtij kriteri për sigurimin e ngjashmërisë në 80% të kurrikulës së ofruar në programet “Master”, (të cilët formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë), pasi nuk ekziston një program tjetër i ngjashëm studimi”.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 1, përcaktohet se “Programi i studimeve Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, pranë Departamentit të Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP), Fakulteti i Muzikës (FM), në Universitetin e Arteve (UART)”. Në Nenin 11 të kësaj Rregullore “Pranimi i studentëve”, parashikohet se “Në UART, pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master Profesional” bëhet me konkurs”. (Dokumenti 13/L.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Rregullore për zhvillimin e konkursit të pranimit në programet e ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”, “Master i Arteve”/Mësuesi në Fakultetin e Muzikës, UA (2021-2022)”, janë parashikuar kushtet dhe procedurat e konkurimit. (Dokumenti 38/II.1.7.FM Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve MASTER 2021-2022.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022) (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf) mësohet se “Tarifat e parashikuara për programin e studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi përcaktohen përfundimisht nga Bordi i Administrimit, bazuar legjislacionit në fuqi, dhe i përcillen Ministrisë Arsimit dhe Sportit”.</p>

(Dokumenti 39/ II.1.9 Miratimi i tarifave.pdf; Dokumenti 42/II.1.12 Vendimi Nr. 288-1.PDF).

Universiteti i Arteve, për studentët e kategorive të ndryshme (me aftësi të kufizuara, studentët me arritje të caktuara, shtresa sociale me të ardhura të ulëta, etj), ndjek politika të veçanta në dhënien e bursave dhe reduktimin e tarifave. Sipas Dokumentit (40/II.1.10. tarifat e reduktuara te studimit.pdf), numri i studentëve me **reduktim 50% nga tarifa e shkollimit** për programin e MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi për vitet akademike 2019-2022, është si vijon:

Programi studimit	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi	7 studentë	19 studentë	12 studentë

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.

Programi i Studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofrohet vetëm në Departamentin e Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzkore (KMDP), të Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, i cili gëzon Status të veçantë me VKM–së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH”. (Dokumenti VKM–së Nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH).

Gjatë vizitës në instrucion, në takimin me autoritetet drejtuese të institucionit, GVJ mësoi se *nuk ka një program studimi të ciklit të dytë Master, me të njëjtën emërtesë dhe njëkohësisht nga e njëjta fushë studimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për të krahasuar ngjashmërinë në përmbajtje sipas përcaktimit në këtë kriter, së paku 70 për qind.* (Vizita në institucion, datat 9.12.2022 dhe 12.12.2022).

Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.

Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” zotëron kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MAS me anë të VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”. <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/05/11/310> si dhe Standarteve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit: Fields of Education and Training 2013:

- Fusha e studimit – Arte dhe Shkencave Humane (kodi 02)
- Fusha e përgjithshme - Arte (kodi 021)
- Fusha specifike – Muzikë dhe Arte Performuese (kodi 0215)

(Dokumenti 41/ II.1.11 kodifikimi i programeve.pdf)

	Sipas RVB (2022), programi i studimit Master Profesional Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, zhvillohet në fushën kryesore të Arteve dhe Shkencave Humane (kodi 02), atë të përgjithshme Arte (kodi 021) të Arsimit 01 dhe fushën specifike Muzikë dhe Arte Performuese (kodi 0215). (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” nuk ofrohet si program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)			
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në tërësinë e dokumentacioneve që e shoqërojnë, dëshmon se kryesisht është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Referuar të dhënave të deklaruara nga Institucioni në RVB (2022, fq.18) lidhur me Standardin II.1, kriteri 5, <i>GVJ konstaton nevojën për të rishikuar me kujdes numrin e krediteve dedikuara grup-lëndëve të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik në programin e studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, për të siguruar përputhshmëri me Ligjin 80/2015 për AL, Nenin 83 “Programet e studimit në fushën e mësuesisë”, pika 3, që përcakton se “Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cllësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Bazuar në DVV (e-ASCAL) dhe dokumentacionin e siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se Fakulteti i Muzikës si njësi kryesore, dhe Departamenti Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP), si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike. Fakulteti i Muzikës, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në

institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. FM ka në përbërje të tij, 3 njësi bazë:

1. Departamenti Interpretimit
2. Departamenti Kanto
3. Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP)

Referuar të dhënave në tabelën përkatëse për Personelin Akademik me kohë të plotë, viti akademik 2021-2022 (Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategoria: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë), mësohet se FM ka gjithsej **152 personel akademik**, nga të cilët **84 Personel Akademik Efektiv (PAE)** dhe **68 Personel Akademik me Kontratë (PAK)**, me nivel kualifikimi si në tabelën më poshtë:

Viti akademik 2021		
Fakulteti i Muzikës	PAE	PAK
Prof. /Prof. Dr.	17	7
Prof. As. Dr.	17	1
Dr. / Doc.	13	6
MSc.	37	54
Gjithësej	84	68
Totali	152	

Njësi bazë, Departamenti i Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMDP), përgjegjës për programin e studimit Master Profesional për Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, përmbush detyrimet për numrin minimal të përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe shkallën e kualifikimit të stafit akademik, si në tabelën më poshtë:

Viti akademik 2021-2022		
Departamenti KMDP	PAE	PAK
Prof. /Prof. Dr.	5	5
Prof. As. Dr.	4	-
Dr. / Doc.	3	5
MSc.	13	13
Gjithësej	25	23
Totali	48	

Referenca: Dokumenti 6/Tabelat -Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf, Kategoria: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë për programin e studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi; *Dokumenti 43/II.2.1.Personeli Akademik me Kohë të Plotë Njësi Bazë KMDP.pdf;*

	<p>Për sa më sipër njësia kryesore (FM) dhe njësia bazë (KMDP) përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme; - organizimin dhe strukturën akademike;
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> <p>Sipas RVB (2022), struktura administrative dhe ndihmës akademike në Fakultetin e Muzikës përbëhet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ: <ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria e Fakultetit të Muzikës - Kryesekretarja - Specialisti për kurrikulën dhe informimin e studentëve ➤ Struktura administrative: <ul style="list-style-type: none"> - Kryetari i Degës së FM - Punonjësit e shërbimit. ➤ Struktura ndihmës akademike me karakter akademik: <ul style="list-style-type: none"> - Specialistët (laborantët) e Fakultetit të Muzikës <p>Për shkak të specifikës së programeve të studimit pranë Njësive Bazë të Fakultetit të Muzikës, personeli ndihmës akademik ka varësi të drejtpërdrejtë nga njësia kryesore (FM).</p> <p>Kryetari i degës mësimore zhvillon veprimtarinë bazuar në parashikimet e Rregullores së Fakultetit të Muzikës Neni. 17. Sekretaria mësimore ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Rregulloren e FM dhe atë të sekretarisë. (Dokumentet 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Kreu XII “Praktika profesionale”, Neni 28, pika 1, 3 dhe 4, shprehet se: (1) Në UA zhvillohen praktika mësimore të parashikuara si pjesë e planeve mësimore në mbështetje të formimit të profesioneve të rregulluara të mësuesisë sipas syllabuseve dhe formës së diplomës të miratuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. (3) Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti KMDP. (4) Personeli akademik që drejton atë, mban lidhje me Institucionin ku ajo kryhet për secilin student. (Dokumentet 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit</p>	<p>FM/DKMDP përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se për çdo student të programit të studimit cakton një person në rolin e Këshilltarit Akademik. Në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe</p>

<p>të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Mësuesi” (2022), Neni 41 “Këshilltari akademik i studentëve”, përshkruhet se “Çdo student në UART ka të drejtën për të pasur një këshillues akademik. Në programin e studimit MP në Kitarë dhe Mësuesi, pedagogu i Kitarës (speciale) është njëherazi edhe këshilltari akademik i studentit. Ai ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë kohës së qëndrimit në UART dhe bashkëpunon me këshillat e studentëve. Detyrat kryesore të Këshilluesit Akademik janë përcaktuar në mënyrë të detajuar në dokument. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), Departamenti KMDP përmban edhe grupet mësimore të përfaqësuara nga kryetari/tja e tyre. Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore në Fakultetin e Muzikës, Neni. 15, Grupi Mësimor Muzikologji është përgjegjës për lëndët e programit të studimit Master Profesional Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi. Kryetari i njesisë cakton nje pedagog si koordinator i cili vlerëson pjesëmarrjen dhe cilësinë e realizimit për çdo student. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Departamentit të KMDP (2022)”, Neni 28 “Praktikat profesionale dhe mësimore”, pika 3, shprehet se “Për mbikqyrjen e zhvillimit të praktikës mësimore (profesionale), përgjegjësi i departamentit cakton pedagogun që do të ndjekë, vlerësojë dhe plotësojë dokumentacionin e praktikës mësimore. Drejtimi i praktikave nga pedagogu përkatës nuk përfshihet në ngarkesën mësimore në auditor dhe vlerësohet në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, pika II.12, gërma (e)”. (Dokumenti 23/ I.2.3. 2022_VSA_44.pdf)</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe</p>	<p>Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i KMDP, përgjegjës për Programin e Studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” dëshmon se disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë, të shtjelluara në mënyrë të hollësishme në dokumente rregullatore të përgjithëshme dhe të posaçme, si:</p>

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021). (Dokumenti 17/I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf). - Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Departamentit të KMDP (2022). (Dokumenti 23/ I.2.3. 2022_VSA_44.pdf) - <i>Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në UA</i> (2021) (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf). - <i>Rregullore mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në "Kitarë dhe Mësuesi"</i> (2022). (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet për ndarjen e lëndëve në vite e semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit për secilën lëndë/modul, tipin e veprimtarisë mësimore, formën e kontrollit, dhe komponentët të tjerë informues. Plani Mësimor i programit të studimit, përmban 22-25 lëndë / module, duke përfshirë 2 ose 3 lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale dhe diplomimin. Komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet në total me 120 kredite. Në fund të Planit Mësimor gjendet një shënim sqarues lidhur me numrin e krediteve për lëndët me zgjedhje që duhet të fitojë studenti për çdo semestër gjatë dy viteve akademike. Në këtë shënim, respektivisht jepet informacion se <i>"Studenti duhet të zgjedh në total 9 ECTS, prej të cilave 3 në semestrin I-II dhe 6 në semestrin III-IV"</i>. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).</p> <p><u><i>GVJ vëren</i></u> se në grupin e lëndëve me zgjedhje gjendet dy lëndë shumë të veçanta. Një lëndë e titulluar <i>"Praktikë në ngjarje shkencore aktive"</i>, 2 kredite, që sipas Planit Mësimor realizohet si orë pune individuale dhe përmbillet me formën e kontrollit "Firmë" (F). Lënda tjetër titullohet <i>"Pjesëmarrje (në aktivitet)"</i>, vlerësuar me 1 kredit, e cila realizohet si orë pune individuale, por në Planin Mësimor nuk pasqyrohet ndonjë informacion për formën e kontrollit të dijeve në përfundim të kësaj lënde.</p> <p>Gjithashtu, në Planin Mësimor nuk është pasqyruar <i>shuma e orëve në fund të çdo kolone</i> (orë mësimore në auditor, orë pune individuale, orë/javë për çdo semester, etj.). Mungesa e këtyre të dhënave e bën të vështirë analizën për raportin e totalit të orëve të realizuara në auditor dhe totalit të orëve të realizuara jashtë auditorit, si dhe totalin e orëve mësimore të realizuara brenda dhe jashtë auditorit në një javë mësimore, për çdo semester.</p>



	<p>Ndërsa, orët e lëndës “Praktikë mësimore” janë <i>shënuar gabimisht në kolonën “Orë pune individuale”, në vend të kolonës “Orë mësimore në auditor”.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që të rishikohet plani nga pikëpamja e qartësisimit të informacionit që përmban dhe të korrektohet gabimi teknik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, pika 2.1 “Kreditet sipas ECTS-së”, germat (e) dhe (ë), lidhur me kriterin 3, shprehen si më poshtë:</p> <p><i>e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.</i></p> <p><i>ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kritereve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.</i></p> <p>Këto përcaktime gjejnë pasqyrim në dokumentet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021)”, Neni 27, “Pranimi në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë”, Neni 30, “Transferimet”, Neni 31 “Kriteret e procesit të transferimit të studimeve”. (Dokumenti 17/I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf). - <i>Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në UA (2021) Neni 10, “Pranimi i studentëve në programet e ciklit të dytë”, Kreu VI “Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve”, Neni 24, 25. (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</i> - <i>Rregullore mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 11 “Pranimi i studentëve”, Kreu VI “Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve”, Neni 24 (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</i> <p>Në këto dokumente rregullatore përcaktohen të gjitha modalitetet, rregullat, procedurat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit. Këtu studenti mund të informohet për të gjitha të drejtat dhe detyrime e tij, si edhe për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,</p>

	<p>transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Në dokumentin “Rregullore mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 40, “Informimi i studentëve”, përcaktohet se “Në UA ka një sistem të organizuar informimi për të transmetuar tek studentët të gjithë informacion e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme, etj. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) <i>Format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, etj. , të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve;</i> b) <i>Në format elektronik në faqen zyrtare të UART I cili është I aksesueshëm nga të gjithë studentët;</i> c) <i>Të shpallura në mjediset e FM.</i> <p>(Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikkat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për lëndë/modul, për praktikkat, seminarat apo orët e laboratorit si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Referuar dokumenteve në e-ASCAL (49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF; 35/ II.1.4 syllabus pedagogji muzikore.pdf) (49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF) për programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të marrë në vlerësim, vërehet se syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/ specifikë të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e orëve të leksioneve dhe seminareve apo orët e laboratorit për secilën lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale, formën e kontrollit të dijes, bibliografinë e detyruar dhe atë të rekomanduar, etj.</p> <p>Për sa më sipër, mund të vlerësohet se syllabuset përmbajnë elementet e përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, shtojca nr. 2 “Programi i lëndës”, pavarësisht se formati i shumicës së tyre nuk ndjek të njejtën linjë me formatin e përcaktuar në VKM nr. 41/2018.</p> <p>Sipas RVB (2022), përmbajtja e programit të lëndëve (syllabuset) janë hartuar në përputhje me elementët e kërkuar sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar dhe formatit të miratuar në nivel institucioni”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p>

	<p>Në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Neni 10, mes të tjerash përcaktohet se: (1) Programi mësimor i lëndës/syllabusi hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH”. Programi i studimit ka natyrë specifike dhe syllabuset e tij kanë elementë dhe përbërje të veçantë. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>GVJ ka konstatuar se në dokumentin (49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF) <i>mungon syllabusi dy lëndëve nga grupi i lëndëve me zgjedhje</i>. Një lëndë e titulluar “Praktikë në ngjarje shkencore aktive”, 2 kredite, lënda tjetër titullohet “Pjesëmarrje (në aktivitet)”, vlerësuar me 1 kredit. Në këtë kuadër, GVJ sugjeron të dokumentohet syllabusi i dy lëndëve me zgjedhje të përmendura më lartë.</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Në dokumentin RVB (2022), institucioni deklaron se me <i>Urdhër të MASR Nr.512, datë 24.10. 2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve”</i>, (Dokumenti 1/1.MP Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi / PM Music Education and Teaching), në periudhën 2019-2020, programi i studimit Master Profesional Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi ka pasur ndryshime mbi masën 20% ... ka pësuar një rishikim rrënjësor në përshtatje me tregun e punës (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Në rast të identifikimit të nevojës për ndryshime/përmirësime/përditësime të programit studimor, institucioni ndjek procedurat e përcaktuara në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Kreu IX “Vlerësimi i cilësisë”, Neni 38, “Rishikimi periodik i programit të studimit”, i cili shprehet se:</p> <p>(1) <i>Fakulteti i Muzikës në bashkërendim me strukturat përkatëse të UART, nëse është e nevojshme, për ndryshime mbi 15% të programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit me grupin që është përgjegjës për këtë proces. Grupi i rishikimit përcaktohet nga përgjegjësi i njësisë bazë DI.</i></p> <p>(2) <i>Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Dekani i fakultetit së bashku me strukturat përkatëse në UART, organizojnë procesin e tërheqjes së opinionëve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha disiplinat. Procedura se si organizohet ky proces përcaktohet nga Rektori</i></p>

	Neni 39, "Regjistrimi, ruajtja e të dhënave, raportimi", përcakton se (1) <i>Të gjitha të dhënat e grumbulluara ruhen në një dosje të veçantë të programit të studimit në arkivin e fakultetit. Kjo dosje i vihet në dispozicion grupit të rishikimit në momentin e realizimit të rishikimit të programit të studimit.</i> (3) <i>Raporti i rishikimit të programit të studimit analizohet nga Senati Akademik i cili e miraton atë.</i> (Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf).		
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi është kryesisht i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. <i>GVJ sugjeron që të rishikohet Plani Mësimor nga pikëpamja e qartësisht të informacionit që duhet të përmbajë, veçanërisht për shumën e totalit të orëve brenda dhe jashtë auditorit. Gjithashtu, GVJ sugjeron që të dokumentohet syllabusi i dy lëndëve me zgjedhje, titulluar "Praktikë në ngjarje shkencore aktive", 2 kredite, dhe "Pjesëmarrje (në aktivitet)", vlerësuar me 1 kredit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi i studimit i marrë në vlerësim është riorganizuar në vitin 2019, me Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019 "Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve". Gjatë këtij procesi, emërtimi i programit ndryshoi nga Master Profesional në Pedagogji Muzikore (90 kredite) (Dokumenti 61/II.1.5.3 urdhri Nr.397, date 10.08.2011.pdf) në Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (120 kredite) (Dokumenti 1/Urdhër Nr.512, datë 2019-10-24 "Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve").</p> <p>Sipas Dekanit të FM, gjatë vizitës në institucion, argumentohet se qëllimi i riorganizimit ishte që ky program studimit të krijonte mundësi për thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve jo vetëm në fushën e muzikës/instrumentit, por edhe në fushën e mësuesisë. Nga kjo perspektive, të diplomuarit në këtë program studimi do të kenë një diversitet mundësish për të vijuar studimet, si: Master i Shkencave në fushën e Muzikës dhe/ose Master i Shkencave në fushën e Pedagogjisë/Edukimit, si dhe mundësi të gjëra punësimi në sektorë ku kërkohen interpretë muzikorë apo punësim në sektorë të edukimit, si</p>

	<p>shkolla, qendra kulturore për fëmijët, etj... Riorganizimi i programit të studimit u shoqërua me ndryshime jo vetëm në emërtim, por edhe në përmbajtjen e veprimtarive mësimore të programit, në shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave mësimore.</p> <p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 1, shprehet se “...Programi i ciklit të dytë të studimeve, është riorganizuar për t’ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm të ulët. Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me nivelin 7 (shtatë) sipas Nivelit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).” Neni 7 i këtij dokumenti, specifikon se “...Përmbajtja e programit të studimit vjen si vazhdimësi llogjike e programit të ciklit të parë Pedagogji Muzikore dhe synon thellimin e njohurive të studentit me kulturë muzikore dhe përgatitjen profesionale pedagogjike”. Neni 8, përkufizon se “Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” pajis studentin me njohuri të thelluara mbi pedagogjinë në përgjithësi dhe atë muzikore në veçanti ... Ata marrin një formim muzikor të gjithanshëm për të dhënë kulturë muzikore në insitucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Studentët aftësohen t’u mësojnë fëmijëve materiale muzikore nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ata kanë kompetencën për të dhënë mësim muzike me një instrument muzikor ... Praktikant mësimore i japin mundësinë studentëve të mësojnë dhe zbatojnë në praktikë atë çfarë kanë mësuar në orët teorike dhe praktike në auditore”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Për sa më sipër, dëshmohet se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për punësimin e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut në fushën e kulturës muzikore dhe mësimdhënies së lëndës së muzikës me një instrument muzikor.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor (2021-2022), vërehet se programi i studimit është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Lidhur me shpërndarjen e lëndëve/moduleve sipas kategorive nga A në E, për çdo vit akademik të Planit Mësimor, vërehet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Në vitin e I-rë akademik zhvillohen 14-15 lëndë/60 kredite:</u> <ul style="list-style-type: none"> - 0 lëndë të kategorisë A (lëndë bazë/ 0 kredite) - 8 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/37 kredite) - 3 lëndë ndërdisiplinore (11 kredite) dhe 1-2 lëndë me zgjedhje (ndoshta 3 kredite) të kategorisë C (gjithësej ndoshta 14 kredite)

	<ul style="list-style-type: none"> - 2 lëndë plotësuese (6 kredite) dhe 1 lëndë praktika (3 kredite), të kategorisë D (gjithësej 9 kredite) ▪ <u>Në vitin e II-të akademik zhvillohen 10-11 lëndë/60 kredite:</u> <ul style="list-style-type: none"> - 3 lëndë e kategorisë A (lëndë bazë/ 12 kredite) - 2 lëndë e kategorisë B (lëndë karakterizuese/ 8 kredite) - 2 lëndë ndërdisiplinore (7 kredite) dhe 1-2 lëndë me zgjedhje (ndoshta 6 kredite) të kategorisë C (gjithësej ndoshta 13 kredite) - 1 lëndë e kategorisë D (praktika 3 kredite) - 1 lëndë e kategorisë E (diploma/ 24 kredite) <p>Në total, duket se programi i studimit përfshin 24-26 lëndë, duke përfshirë lëndët me zgjedhje, praktikën mësimore dhe diplomën.</p> <p>Praktika mësimore (kategoria D/6 kredite/150 orë) ka shtrirje në dy vite akademike.</p> <p>Praktika mësimdhënëse (6 kredite/150 orë) realizohet e përqëndruar vetëm në tre javë për çdo vit akademik. Në planin mësimor orët e praktikës mësimdhënëse janë <u>shënuar gabimisht</u> në kolonën “orë pune individuale”, ndërkohë që duhen llogaritur në kolonën “orë mësimore në auditor”.</p> <p>Diploma (kategoria D/24 kredite/600 orë) realizohet në semestrin e dytë të vitit të dytë, alokuar si orë punë individuale e studentit. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Neni 29, pika 6, specifikohet se “Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një Mikroteze. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime shkencore në fushën përkatëse”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Për sa më lartë, GVJ vlerëson se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Megjithatë, <u>GVJ sjell në vëmendje të institucionit</u> nevojën për të rishikuar Planin Mësimor nga pikëpamja e qartësisht të informacionit që duhet të përmbajë, veçanërisht shumën e orëve mësimore brenda dhe jashtë auditorit, si dhe ngarkesën e orëve mësimore javore.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme</p>	<p>Referuar dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Neni 7 përshkruhet se “Programi i studimit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi përmban një strukturë mësimore të grupuar në module si më poshtë: a) lëndë bazë; b) lëndë karakterizuese; c) lëndë</p>

ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.

ndërdisciplinore/integruese; d) lëndë plotësuese. Pjesa më e madhe e lëndëve karakterizuese janë parashikuar të shoqërohen me praktika (ushtrime) intensive mësimore në mënyrë që studenti të parapregatitet edhe praktikisht për ushtrimin e profesionit... (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).

Bazuar në Planin Mësimor (2021-2022), konstatohet se disa lëndë mësimore realizohen me një shtrirje kohore semestrale dhe disa të tjera janë gjithë vjetore ose edhe më shumë. Një semester ka 15 javë mësimore.

Çdo lëndë mësimore e parashikuar për t'u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimore si: leksione (L), seminare (S), ushtrime (U).

GVJ konstaton se *Plani Mësimor nuk informon* sa orë mësimore për një lëndë/modul janë parashikuar të jenë leksione ose seminare ose ushtrime praktike. Kjo e bën të vështirë përcaktimin e raportit teori /praktikë dhe ushtrime.

Përsa i përket Praktikës Mësimore (PM/6 kredite/150 orë), ka shtrirje në dy vite akademike dhe realizohet në shkolla të ndryshme, e përqëndruar vetëm në tre javë për çdo vit akademik. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).

Raporti teori – praktikë në programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi rezulton në favor të teorisë, i shprehur me 95 % kredite teori dhe 5 % kredite praktikë mësimore.

Një analizë më e hollësishme në përmbajtjen e Planit Mësimor tregon se gjenden 5-6 lëndë të veçanta të cilat përfshijnë si formë të mësimdhënies së tyre edhe ushtrimet (U). Pavarësisht se numri i orëve mësimore dedikuar ushtrimeve nuk është pasqyruar në Planin Mësimor, prezenca e ushtrimeve (U) në realizimin e këtyre lëndëve është tregues i lidhjes së teorisë me praktikën, duke kontribuar njëherazi edhe në përmirësimin e raportit teori – praktikë. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf)

Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, në takimin e GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të marrë në vlerësim, u shpjegua se “*Detyrat lëndore / studimore që u jepen studentëve për t'u punuar në auditor ose jashtë auditorit, si dhe teza e diplomimit synojnë që të lidhin ngushtësisht teorinë me praktikën*”.

Referuar RVB (2022) për këtë kriter, mësohet se struktura e programit të studimit përmban lëndë që thellojnë e zgjerojnë njohuritë e marra në ciklin e parë të studimeve ose janë njohuri të reja që kanë një lidhje organike me to, duke siguruar përputhjen me programe të ngjashme kombëtare për mësuesinë ... Ky program studimi i jep një rëndësi të veçantë aspektit praktik, sidomos lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me formimin teoriko-

shkencor, por dhe artistik në të njëjtën kohë. Studentët e këtij programi përgatiten nga ana teoriko-shkencore për metodologjine e mësimdhënies në lëndën e muzikës ... Programi është plotësuar me paketën e lëndëve të mësuesisë, të ngjashme me të gjitha programet e mësuesisë që zhvillohen në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, për ushtrimin e profesionit të rregulluar të Mësuesit me kriteret e ligjit Nr. 10170, dt. 22.10. 2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)

Për sa më lartë, programi i studimit “Master Profesional” në Kitarë dhe Mësuesi, dëshmon se është në përputhje me profilin e programit të studimit, si dhe siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.

Megjithatë, *GVJ sugjeron* që të rishikohet Plani Mësimor i programit të studimit të marrë në vlerësim, me qëllim që të sigurohet informacioni i nevojshëm lidhur me sasinë e orëve mësimore dedikuar leksioneve/seminareve/ushtrimeve të parashikuara për një lëndë/modul.

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Referuar Planin Mësimor (2021-2022) (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf), vërehet se veprimtaritë formuese janë ndarë në kategori A, B, C, D, E, dhe bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 41/2018 (të ndryshuar), kreditet për secilën kategori, të shprehura në %, paraqiten si më poshtë:

Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018, (% e krediteve)	Të dhënat në Planin Mësimor “MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”	
			ETCS	%
A	Lëndë bazë	5%-10%	12	10%
B	Lëndë karakterizuese	30%-40%	45	37.5%
C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	20%-30%	27	22.5%
D	Lëndë plotësuese	10%	12	10%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-20%	24	20%
			120	100%

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në dokumentin “Planin Mësimor 2021-2022”, me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 (i ndryshuar), Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë Master Profesional, dëshmon se elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të

	<p>vlerësuar në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sipas RVB (2022) institucioni deklaron se “Pjesa më e madhe e lëndëve, referuar në total sasisë së krediteve për lëndë, parashikojnë zhvillimin e leksioneve teorike, kryesisht. Nëpërmjet seminareve të cilat organizohen në formën e plotësimit të detyrave konkrete, studentët kanë mundësi të venë në zbatim teorinë që marrin gjatë leksioneve”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Lidhur me kriterin 4, GVJ vlerëson se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Procedurat për transferimin e studentëve përshkruhen në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Kreu VI “Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve”. (Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga autoritetet drejtuese të FM dhe DKMDP, se ka pasur raste transferimi të studimeve nga studentët e këtij programi në universitetet jashtë vendit si: Itali, Francë, Norvegji, Spanjë, sikundër edhe raste që studentë nga Tetova dhe Shkupi, kanë ardhur të vijojnë studimet në programin MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi. (Dokumenti 11/ Minutat e takimeve - MP Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi.docx)</p> <p>Programi i studimit krijon mundësi punësimi të përshkruara në Nenin 37 të dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”. (Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Referuar RVB (2022), deklaron se nëpërmjet këtij programi studentët kanë garanci në përfundim të studimeve për vendin e punës, nisur dhe nga nevojat që ka vendi për mësues muzikë. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Neni 10, mes të tjerash përcaktohet se: (1) Programi mësimor i lëndës/syllabusi hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe VKM nr.145, datë 10.03.2021 “Përdhënie e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në RSH”. Programi i studimit ka natyrë specifike dhe syllabuset e tij kanë elementë dhe përbërje të veçantë. (3) Programi i lëndës/syllabusi është objekt rishikimi në</p>

	<p>përputhje me Planin Mësimor të miratuar. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), Njësia Bazë, Departamenti i KMDP në çdo fillim viti akademik kërkon nga stafit akademik që nëse e shohin të arsyeshme, të dorëzojnë ndryshimet e programit të lëndës/ve të drejtuara prej tyre. Stafit akademik, titullar i lëndëve që zhvillohen pranë Njesisë Bazë KMDP dhe në programin e studimit Master Profesional Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në rastet kur parashikon pasurimin e literaturës bazë dhe asaj ndihmëse, paraqet kërkesën e tij pranë njesisë bazë. Kërkesa e stafit akademik i përcillet bibliotekës së UART e cila, në vazhdimësi, ndjek procedurat për sigurimin e literaturës së kërkuar. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Kjo praktikë e mirë pune e përditësimit të literaturës për programet lëndpre/syllabuset e programit të studimit të marrë në vlerësim, dëshmohet edhe nga dokumenti 50/II.3.4- Rreth ndryshimeve ne programet e lendeve (Syllabus).pdf; dhe dokumenti 54/II.4.1 Komunikim me biblioteken per pasurimin e literatures.pdf.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit dëshmon se garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, <u>Neni 2</u> “Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit”, deklarohet se: <i>Programi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. ... <u>Neni 8</u>, përkufizon se “Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” pajis studentin me njohuri të thelluara mbi pedagogjinë në përgjithësi dhe atë muzikore në veçanti ... Studentët e programit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” zhvillojnë kapacitetet e tyre në fushën e mësimdhënies. Ata marrin një formim muzikor të gjithanshëm për të dhënë kulturë muzikore në insitucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Studentët aftësohen t’u mësojnë fëmijëve materiale muzikore nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ata kanë kompetencën për të dhënë mësim muzike me një instrument muzikor ... Praktikant mësimore i japin mundësinë studentëve të mësojnë dhe zbatojnë në praktikë atë çfarë kanë mësuar në orët teorike dhe praktike në auditore. Aftësohen për të genë të gatshëm për të menaxhuar dhe drejtuar procesin mësimor”. <u>Neni 36</u> shprehet se: <i>Në përfundim të studimeve në programin “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” studenti do të jetë aftësuar në:</i></i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Metodologjinë e mësimdhënies së lëndëve muzikore në nivelet e ciklit të mesëm dhe të ulët të institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj;

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Zotërimin e të paktën një instrumenti;</i> - <i>Zotërimi i aftësive për të organizuar aktivitete kulturore pranë institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë;</i> <p>(Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>						
<p>Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “<i>Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)</i>”, Neni 37, përshkruan se: <i>Studenti i diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi mund të punojë si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Mësues muzike në institucionet e arsimit të ciklit të mesëm të ulët parauniversitar.</i> - <i>Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore.</i> <p>(Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese të shprehura në dokumentin “<i>Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)</i>”, me nivelin e 7 të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, dhe rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Megjithatë, <i>GVJ tërheq vëmendjen për të rishikuar disa aspekte teknike</i>, të lidhura kryesisht me të dhënat informuese që duhet të pasqyrohen në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasqyrimi i shumës në total për orët brenda dhe jashtë auditorit, si dhe për ngarkesën mësimore javore në çdo semester; - Pasqyrimi i sasisë së orëve mësimore dedikuar leksioneve / seminareve / ushtrimeve për një lëndë/modul; - Të shënohen orët mësimore të praktikës mësimdhënëse në kolonën “orë mësimore në auditor”; 						
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet përcaktisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet përcaktisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X	
Përbushet përcaktisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
	X						

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë</p>	<p>Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit të marrë në vlerësim dhe përshtatjen e tij sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, institucioni ndjek procedura të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse.</p> <p>Në dokumentin “<i>Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)</i>”, Kreu IX</p>

<p>përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p><i>“Vlerësimi i cilësisë”</i>, Neni 38, <i>“Rishikimi periodik i programit të studimit”</i>, shprehet se: (1) <i>Fakulteti në bashkëpunim me strukturat përkatëse në UART, nëse është e nevojshme, për ndryshime mbi 15% të programit të studimit, Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i FM aktivizon grupin e rishikimit, i cili është përgjegjës për këtë proces. Grupi i rishikimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë KMDP ... (2) Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik...Procedura se si organizohet ky process përcaktihet nga Rektori. Neni 39 “Regjistrimi, ruajtja e të dhënave, raportimi”</i>, specifikon se: (1) <i>Të gjitha të dhënat e grumbulluara sipas Nenit 39, ruhen në një dosje të veçantë të programit në arkivin e fakultetit. Kjo dosje i vihet në dispozicion grupit të rishikimit në momentin e realizimit të rishikimit të programit të studimit. ... (3) Raporti i rishikimit analizohet nga Senati Akademik dhe miratohet prej tij.</i> (Dokumenti 13/L.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në kuadër të riorganizimit të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (Urdhër Nr. 512, datë 24.10.2019), UART/FSHM dëshmon se është konsultuar me institucionet partnere, sikurse Ministria përgjegjëse për Arsimin (shiko Dokumentin 59/II.5.1 urdhëri për ngritjen e grupit të punës.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se FM/DKMDP ka bashkëpunuar edhe me ish të diplomuarit në fushën e muzikës, si dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, si institucione publike ashtu edhe organizma joqeveritarë, të përfshirë në jetën kulturore, artistike e pedagogjike me qëllim që programi i riorganizuar t’i përgjigjej më mirë kërkesave të tregut të punës. Gjithashtu, FSHM/DKMDP ka siguruar disa bashkëpunime me institucionet partnere për praktikën profesionale, të cilat kanë qënë frytdhënëse për të diskutuar mbi çështje të lidhura me sfidat që ndeshen në tregun e punës. Këto diskutime kanë shërbyer për të analizuar dhe gjykuar mbi nismat e DKMDP për të rishikuar, përmirësuar ose riorganizuar programet që ofron.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>FSHM/ DKMDP nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit</p> <p>Institucioni ka ngritur dhe vënë në funksion NJSBC, e cila sipas dokumentit <i>“Rregullore e funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, 2021”</i>, Neni 3, mes të tjerash shprehet se: <i>Qëllimi i SBC është ... (c) nxitja e studentëve për të qënë aktivë në dhënien e opinioneve mbi çështjet aktuale.</i> Neni 5, përshkruan se: <i>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) përbehet nga 1 specialist i</i></p>

sigurimit të cilësisë në UART, I përfaqësues për secilin fakultet dhe 1 student.... Anëtar i Komisionit, pjesë e studentëve të UART, duhet të jetë me mestare të përgjithshme mbi 8 (tetë). Neni 6 specifikon se midis të tjerash, KSBC bën vlerësime për stafin akademik ... duke filluar me pyetësorët e studentëve. Neni 10, përcakton se: Raporti i KSBC përfshin përshkrime, analiza, përfundime, urdhra dhe rekomandime...” për përmirësimin e programit të studimit. (Dokumenti 158/VI.2.1. rregullore e NJSBC.pdf).

Mendimi i studentëve rreth programit të mësimit, kontakteve të vazhdueshme në Njësinë Bazë KMDP dhe nëpërmjet stafit akademik, sigurohet edhe nëpërmjet pyetësorve të hartuar nga NJSBC sikurse dhe nga vetë FM. (Dokumenti 63/II.5.5 pyetesor.pdf).

Në RVB (2022), institucioni deklaron se Fakulteti i Muzikës, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), duke ndjekur ecurinë, punësimin, arritjet, etj. Fakulteti i Muzikës mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre në bashkëpunim edhe me Sektorin mësimor. UART në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë, sikurse vetë stafi akademik konsultohet me studentët e diplomuar të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë institucioneve të tjera ose si të pavarur. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).

Institucioni ruan kontakte të drejtëpërdrejta dhe të vazhdueshme me studentin nëpërmjet Këshilltarit Akademik. Sipas dokumentit “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022)”, Neni 41, përcaktohet se: Çdo student në UART ka të drejtën për të pasur një Këshillues Akademik ... Ai ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në UART dhe bashkëpunon me këshillat e studentëve. (Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf).

Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se: Këshilluesi Akademik ruan kontakte me studentin edhe pas diplomimit të tij. Shpesh ish të diplomuarit, pavaresisht se ku janë të punësuar, brenda apo jashtë vendit, vijojnë të bashkëpunojnë profesionalisht me pedagogët e tyre në kuadër të aktiviteteve të ndryshme muzikore. Kjo marrëdhënie, u jep mundësi palëve që të diskutojnë profesionalisht për kërkesat e reja në tregun e punës dhe t'i reflektojnë ato në procesin e përmirësimit programit të studimit. Shkëmbimi i përvojës së përshkruar nga stafi akademik ilustron edhe nga Dokumenti III.1.6 aktivitete, foto e mesimdhënies se pedagogeve në institucione të huaja.pdf; Dokumenti 64/II.5.6 Master-Class.pdf.

Institucioni dëshmon se i jep një rëndësi të veçantë konsultimeve me studentët e diplomuar të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në funksion të përmirësimit dhe pasurimit të

	kurrikulës, sikurse dhe të shkëmbimeve akademike (Dokumenti 62/ II.5.4 Kontakt me Alumni per aktivitet_Redacted.pdf).		
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>FM/DKMDP dëshmon se ka përmirësuar, përditësuar dhe përshtatur programin e studimit të marrë në vlerësim, duke e transformuar atë nga MP në Pedagogji Muzikore në MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (Urdhër Nr.512, datë 24.10.2019), duke reflektuar në këtë mënyrë propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e muzikës dhe mësimdhënies së muzikës në sistemin parauniversitar, në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, institucione të artit dhe kulturës.</p> <p>Sipas RVB (2022) mësohet se programi i studimit është në përditësim të vazhdueshëm me zhvillimet më të fundit në fushën e edukimit muzikor. Vetë stafi akademik, falë eksperiencës personale brenda e sidomos jashtë vendit, siguron shpesh herë të dhëna rreth aktualitetit artistik dhe kërkesave të kohës. Gjithashtu një prej mënyrave të zgjedhura nga Njësia Bazë KMDP, për sigurimin e informacionit rreth zhvillimeve më të fundit, është nëpërmjet ofrimit të Master-Class-eve nga pedagogë dhe artistë të huaj. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p>		
Konkluzione	UART/FM/D/KMDP nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës” (2021), Neni 26, pika 1 dhe 4, shprehet se: <i>Programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në Fakultetin e Muzikës, janë programe të një formimi karakterizues të formimit special, por që ofrojnë edhe fushën e mësuesisë, në...Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi.</i> (Dokumenti 17/ L.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 2, përcaktohet se “Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, nëpërmjet aktiviteteve formuese,</p>

	<p>teorike dhe praktike, është të plotësojë nevojat e tregut arsimor dhe atij të sektorit të kulturës me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësues të muzikës për Institucionet arsimore parauniversitare, të ciklit të mesëm të ulët. - Mësues/instruktorë për qendrat kulturore private. - Punonjës të rrjetit të institucioneve kulturore/muzikore <p>Ky Program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në dokumentin “Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në Universitetin e Arteve” (2021), Neni 31, përcakton se: <i>Punimi diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti/programi artistik apo të një studimi me karakter përgjithësues në fushën e programit të studimit që ka kryer. Punimi diplomës përmban një sërë detyrash dhe kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore projektuese artistike të tregojë aftësitë e tij profesionale-artistike dhe kompetencën për të kryer studime, projekte dhe realizime artistike në fushën përkatëse.</i> (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Në RVB (2022) deklarohet se “Objektivat e programit të studimit janë hartuar në përputhshmëri me ato të parashikuara në Statutin e UART, Neni. 4 dhe 7, me Rregulloren e Përgjithshme dhe asaj Mësimore në Fakultetin e Muzikës, Neni. 4, dhe me Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj mësimore në Departamentin KMDP, Neni 4. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i Etikës të UA” (2020), Neni 5 i tij, pika 1, që shprehet se <i>“Personeli akademik gëzon liri akademike në kërkimet, punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë kërkimin artistik-shkencor, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efektive, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët”.</i> (Dokumenti 89/ III.3.6 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</p>

	<p>Në RVB (2022) (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf), institucioni deklaron se çdo fillim viti akademik, bazuar në strukturën vjetore të shpallur nga rektori i UART (Evidenca II.6.1), Fakulteti i Muzikës, nëpërmjet zv.dekanit, përgjegjësit të departamentit dhe sekretarisë mësimore, përcakton orarin e mësimit (Dokumenti 66/ II.6.2. FM-Orari-mesimor-2021-2022.pdf). Bazuar në rregulloren e programit të studimit, Neni. 14, drejtuesi i departamentit KMDP realizon shpërndarjen e ngarkesës mësimore (Dokumenti 67/ II.6.3. ngarkesa e stafit akademik.pdf) duke respektuar lirinë e stafit akademik në hartimin e programit të lëndës së tij. ... FM dhe DKMDP, mbështesin dhe organizojnë veprimtari kërkimore –artistike-shkencore të stafit akademik. Me nënshkrimin e aktmarrëveshjes, mes pedagogut dhe përgjegjësit të Njesisë Bazë, përcaktohet edhe veprimtaria kërkimore-artistike-shkencore (Dokumenti 68/ II.6.4 Marreveshja 2021-2022 KMDP.pdf), në funksion të së cilës, me përfundimin e vitit akademik, pedagogu duhet të dorëzojë dokumentacionin mbështetës (Dokumenti 69/ II.6.5 veprimtari shkenc e stafit akademik.pdf) ... DKMDP organizon një sërë aktivitete me pjesëmarrjen e stafit akademik si koncerte, tryeza shkencore, leksione të hapura etj., (Dokumenti 70/ II.6.6 aktivitete.pdf).</p> <p>Për sa më lartë, GVJ vlerëson se FM/ DKMDP nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore-artistike.</p> <p>Për përmbushjen e këtij kriteri, FSHM/ DKMDP udhëhiqet nga “Kodi i Etikës së UA (2020)”, Neni 5 i tij “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, pika 3, që përcakton se <i>“Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lire dhe të pavarur, si dhe t’u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit”</i> (Dokumenti 89/ III.3.6 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</p> <p>Referuar RVB (2022) (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf) deklarohet se DKMDP, ka mundur të realizojë disa aktivitete me praninë e studentëve. Studentët informohen vazhdimisht, kryesisht në mënyrë elektronike dhe në web ose rrjetet sociale të UART, për aktivitete të ndryshme që zhvillohen brenda dhe jashtë territorit të vendit. Përgjegjësi i DKMDP siguron, nëpërmjet sektorit të IT, publikimin e aktiviteteve në formë elektronike (Dokumenti 72/ II.6.8 - per njoftim.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se studentët e programit të marrë në vlerësim angazhohen nga pedagogët e tyre në detyra kursi me karakter studimor me qëllim zhvillimin e aftësive për të hulumtuar dhe shqyrtuar</p>

	literaturën përkatëse. Gjithashtu, studentët angazhohen në realizimin e projektit kërkimor në kuadër të punimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. FM /DKMDP përfshin studentët në aktivitetet artistike dhe shkencore të organizuara në nivel fakulteti, në projekte mobiliteti dhe veprimtari të ndryshme studimore/artistike, me përfshirje edhe të stafit akademik.						
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet nga ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>Në dokumentin “Statuti i UA” (2021), Neni 119 “Për financimin e kerkimit artistik/shkencor”, pika 4, specifikohet se “Në buxhetin që përcaktohet nga Administratori i UART për çdo njësi kryesore sipas planifikimit të argumentuar, duhet të përcaktohet edhe një fond që të mbështesë veprimtarinë mësimore-kërkimore-shkencore”. Neni 120, pika 1, shprehet se “UART nëpërmjet njësite përbërëse u ofron të tretëve ose pranon oferta për kërkim artistik – shkencor, ekspertizë artistike – shkencore, shërbime të tjera ose i realizon ato në bashkëpunim me të tretë. Pika 2, përcakton se “Të ardhurat që krijohen nga ky shërbim, administrohen nga UART në favor të njësisë përkatëse që e ofron këtë shërbim në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”. (Dokumenti 12/I.1.2 Statuti i UART.PDF)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se “Për specifikën e strukturës së Universitetit të Arteve, Departamenti i KMDP nuk administrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Këto të ardhura administrohen në mënyrë të centralizuar”.</p> <p>Në RVB (2022) deklarohet se Universiteti i Arteve në përputhje me misionin e tij të mësimdhënies, të artit dhe kulturës e të kërkimit artistik/shkencor dhe në respektim të lirisë së individit, përcakton në buxhetin e tij një fond për çdo njësi kryesore sipas planifikimit të argumentuar. DKMDP paraqet rregullisht propozimet për mbështetjen financiare, drejtuar Administratorit të UART, të të gjitha veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen dhe promovimin e programit të studimit Master Profesional Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi ... Mbështetja financiare parashikohet në Projekt Buxhetin Afatmesëm (PBA), për të konkretizuar çdo vit akademik. Një vend të rëndësishëm në mbështetjen financiare të kërkuar zë aktiviteti artistik-shkencor i stafit akademik dhe mbështetja e veprimtarive të studentëve. Një pjesë e kërkesave të DKMDP sigurojnë mbështetje financiare nga institucioni, sidomos përsa i përket projekteve që lidhen me investimet në teknologji. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p>						
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përcaktohet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përcaktohet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përcaktohet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IL7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>FM/DKMDP dëshmon se mbështet grupet lëndore dhe projektet artistike/shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera brenda fakultetit për realizimin e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Kjo praktikë është sanksionuar në dokumentet rregullatore të institucionit, si: Rregullore e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore e Fakultetit të Muzikës, Neni 15 dhe 16, (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf), si dhe Rregullore Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore të Njesisë Bazë DKMDP, të Fakultetit të Muzikës, në UART, Neni 9 dhe 10. (Dokumenti 23/ I.2.3. 2022_VSA_44.pdf)</p> <p>Në RVB (2022) institucioni deklaron se “Njësia Bazë KMDP, mbështet grupin mësimor Muzikologji dhe Pedagogji Muzikore, duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse pranë Fakultetit të Muzikës, si ato administrative, kryetari i degës, laborantët etj, në organizimin e aktiviteteve artistike dhe atyre akademike”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>FM/DKMDP dëshmon se angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për projekte me karakter artistik/ shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaron se “bashkëpunimet e kësaj njësie janë në rafshin e aktiviteteve artistike ose konsulencë për organizimin e aktiviteteve në fushën e muzikës dhe promovimin e produktit artistik ... si dhe me Ministrinë e Kulturës për materializimin e thirrjes dedikuar “Fondit të Krijimtarisë Muzikore Shqiptare” ... Gjithashtu, një pjesë e mirë e pedagogëve të angazhuar pranë Njesisë Bazë KMDP, ofrojnë vazhdimisht ekspertizën e tyre për realizimin e projekteve artistike dhe atyre shkencore”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Njësia Bazë (DKMDP), në zbatim të iniciativës “Pakti për Universitetin”, dhe marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur mes Universitetit të Arteve dhe Ministrisë së Kulturës, ka angazhuar studentët dhe pedagogët e programit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në projektin “Safeguarding of ICH and Community-based ICH Inventorying”. (Dokumenti 76/IL.6.12 projekti trashëg kulturore jomateriale.pdf)</p>

<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse dëshmon se organizon aktivitete të ndryshme artistike/shkencore, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p> <p>Në kuadër të 60 vjetorit të themelimit të UART, gjatë vitit akademik 2021-2022, Fakulteti i Muzikës, ka realizuar mbi 60 aktivitete artistike dhe shkencore, si: koncerte, promovime, konferenca. (Dokumenti 69/ II.6.5 veprimt shkenc e stafit akademik.pdf ; Dokumenti 70/II.6.6 aktivitete.pdf; Dokumenti 77/II.7.2 aktiv 60 vjetori.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), FM/DKMDP, si njësi përgjegjëse ofruese të programit të studimit, organizon një sërë aktivitete për thellimin dhe diversifikimin e formimit teorik të studentëve dhe pedagogëve, sikurse dhe për implementimin praktik të veprimtarisë artistike. Një pjesë e aktiviteteve të sipërpërmendura realizohen edhe nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që UART ka me institucione të tjera. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Një shëmbull i admirueshëm në këtë kuadër bashkëpunimi, është edhe realizimi i Master-class me Prof. Johannes Kretz (Përgjegjës i Departamentit të Kompozicionit, Elektroakustikës dhe Inxhinierisë së Zërit pranë Universitetit të Muzikës dhe Arteve Interpretuese të Vjenës) mbështetur nga Ambasada Austriake Tiranë. (Dokumenti 79/III.1.4 Simaku, Bieti.pdf)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022)”, Neni 2, përcakton se: “Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike, për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve artistike të vetë studentëve ... Njëherazi, programet e lëndëve sikurse dhe vetë plani mësimor, janë hartuar në ngjashmëri me të njëjtat lëndë në vendet e zhvilluara, kryesisht, të Evropës Perëndimore”. (Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaron se “... programi formon mësues muzike profesionistë, të aftë të përballen me tregun e punës në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmbajtja e programit të studimit është hartuar sipas modeleve të programeve të ngjashme, dhe duke e përshtatur me legjislacionin dhe kornizën shqiptare të arsimit në Republikën e Shqipërisë”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se gjenden mjaft nga studentët e diplomuar në UART/FM/ DKMDP të cilët janë punësuar jashtë vendit dhe performojnë me sukses në institucione artistike ndërkombëtare, si dhe disa prej tyre janë të mirënjohur dhe me famë botërore për nga kualiteti artistik.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet</p>	<p>FM/ DKMDP si pjesë e UART, dëshmon përmes dokumentit (166/Tabela 5.pdf) se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me rrjete</p>

<p>e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>profesionistësh nga fusha e arsimit, si DAR/ZAV, dhe me institucione/qendra artistike, etj., me të cilat bashkëpunon për realizimit të praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore-artistike, dhe që ndihmojnë njësinë përgjegjëse të reflektojë dhe të punojë për mbarëvajtjen, përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të posaçme me fushë specifike të studimit, sikurse programi MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi. Në këtë proces ndihmojnë edhe sugjerimet dhe ekspertiza e ofruar nga profesionistë/artistë brenda dhe jashtë vendit të cilët bashkëpunojnë në kuadër të projekteve kombëtare/ndërkombëtare. (Dokumenti 81/III.1.6 aktivitete, foto e mesimdhënies se pedagogeve ne institucione te huaja.pdf)</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaroi se “për t’i bërë studentët më konkurrues në tregun e punës, u realizua riorganizimi i programeve të studimit të ciklit të dytë Master Profesional, me 120 ETCS, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mesimdhënës në lëndët e artit, pranë institucioneve të arsimit parashkollor, ciklit të mesëm të ulët e të lartë. Programi u riorganizua në bazë ... të Ligjit Nr. 10170, dt. 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Urdhrit Nr.100, dt.25.2.2022, për miratimin e Rregullores për zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesit”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi përputhet me aktet ligjore në vend, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 (i ndryshuar me Ligjin Nr.10357, dt. 16.12.2010, me Ligjin Nr.10470, dt. 13.10.2011 dhe Ligjin Nr.90/2015, dt. 17.07.2014) “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Nenin 8 të tij që përcakton kriteret për të diplomuarit përpara se të ushtrojnë në një profesion të rregulluar, duhet që: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në Urdhrin e Profesionit përkatës, që në rastin e mësuesit janë Drejtoritë Arsimore Rajonale. https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRR1.pdf - Urdhër nr.437, datë 20.07.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. https://arsimiparauniversitar.gov.al/urdher-nr-437-date-20-07-2022-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-rregulloren-per-organizimin-dhe-zhvillimin-e-praktikave-profesionale-per-profesionin-e-rregulluar-te-mesuesit/
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional Në Pedagogji Muzikore dhe Mësuaesi, garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 13, pika 1, midis të tjerash deklarohet se “Në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi aplikohen format e mësimdhënies si: mësimdhënie individuale artistike, leksione, seminare, ushtrime (individuale dhe në grup), praktikatat profesionale, praktikatat mësimore, konsultimet, etj.”. Pika 2 e nenit 13 specifikon se “Mënyra e vlerësimit për arritjet e studentit realizohet nëpërmjet: bashkëbisedimeve, kontrolleve teknike, mbrojtje e detyrave dhe projekteve individuale/grup, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, mbrojtje e temave të diplomave, aktivitete artistike, etj.” Pika 3 përcakton se “Kontrolli i dijes mund të bëhet nëpërmjet: a. Provimit me shkrim; b. Provimit me gojë; c. Kombinimi i dy formave të mësipërme; d. Vlerësimit të detyrave dhe të projekteve; e. Provimi në grup dhe individual”. Pika 4 thekson se “Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së vetë lëndës”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), mësohet se: Nisur nga specifika e programit të studimit, sikurse dhe shumë programe të tjera pranë FM, veçanësisht e zhvillimit të mësimdhënies ka të bëjë me numrin e studentëve në lëndë të caktuara. Zhvillimi i mësimin aplikohet në format si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksioni është shpjegimi i materialit mësimor nga profesori, në përputhje me programin e miratuar - Seminari shërben për të aftësuar studentët të mësojnë në mënyrë aktive dhe efektive. Gjatë seminarit lektori pyet, stimulon, aktivizon dhe ndërvepron me studentët duke përdorur forma të ndryshme dhe teknikat e mësimdhënies;

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ushtrimet, përbëjnë gjithashtu një element të veçantë të mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjatë ushtrimeve pedagogu verifikon detyrat e secilit student duke marrë parasysh individualitetin artistik të tyre, çka nënkupton se çdo detyrë e secilit prej studentëve përbën një rast të veçantë dhe të papërgjithësueshëm me të tjerët.</i> - <i>Praktika Mësimore realizohet pranë institucioneve të arsimit parauniversitar dhe parashikon aftësimin e studentit të mësimdhënie. Në përfundim të praktikës, plotësohet formulari i vlerësimit, i cili nënshkruhet nga mentori në institucionin pritës dhe pedagogu i FM.</i> <p>(Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf; Dokumenti 78/III.1.3. formulari i praktikës mesimore Redacted.pdf)</p> <p>Referuar programeve lëndore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, veçanërisht rubrikës “Mënyra e mësimdhënies” dhe “Kontrolli i njohurive”, vërehet se sipas specifikës së lëndës, janë shënuar format e mësimdhënies të tilla si: leksion, ushtrime, seminare, konsultime, punë individuale, mësim artistik në grup, praktikë, udhëheqje detyrash, etj. Ndërsa si formë të kontrollit të njohurive janë përshkruar: mbremje muzikore, saxho, kontroll teknik, esse, detyra, projekt, kolokium, provim, firmë, koncert, etj. (Dokumenti 49/II.3.3 Sylabus Pedagogji Muzikore.PDF)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, në programin e studimit, bazohen kryesisht në leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat studimore/hulumtuese dhe praktika artistike. Mësimdhënia organizohet në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme si: diskutim, praktikë muzikore, veteksplorim, refleksione, analiza të veprave muzikore, nxitje e mendimit kritik, prezantime në PowerPoint, etj, duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën mësimore dhe ushtrimin artistik. Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në projekte studimore artistike/mobiliteti, në aktivitete artistike kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FM/ DKMDP në bashkëpunim me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit, si dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e</p>	<p>Personeli akademik që mbulon realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim është i mirëtrajnuar, i kualifikuar me grada shkencore e tituj akademikë, si dhe ka përvojë të pasur artistike dhe mësimdhënëse. (Dokumenti 82/ III.1.7 CV me trajnimet e stafit akademik.pdf). Ai</p>

<p>mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>respekton dhe i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>Sipas RVB (2022) mësohet se <i>“Mbështetur edhe nga zhvillimi i teknologjisë dhe investimet e realizuara në këtë drejtim, stafi akademik përdor metoda inovative në transmetimin e dijes përgjatë procesit mësimor”</i>. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se duke u nisur nga natyra dhe kërkesat e lëndës, stafi akademik përkatës zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit, të cilat i përgjigjen objektivave dhe natyrës specifike të lëndës, si dhe diversitetit të nevojave dhe sfidave personale të studentëve. Personeli akademik ofron metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, duke respektuar ritmin e studentëve, si dhe demonstroi se është i hapur për të përmirësuar në vazhdimësi mësimdhënien e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni dëshmon përmes marreveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit se mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. (Dokumenti 1. UART në Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.pdf; Dokumenti 1.1 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.pdf)</p> <p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se ka përfutur nga projekte të mobilitetit dhe trajnimit në fushën e artit dhe mësimdhënies, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e transferimit të përvojës artistike dhe teknikat e mësimdhënies në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit (Dokumenti 79/ III.1.4 Simaku, Bieti.pdf; Dokumenti 81/ III.1.6 aktivitete, foto e mesimdhënies se pedagogeve ne institucione te huaja.pdf)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se <i>“UART ka një zyrë koordinimi për projektet Erasmus+ pranë rektoratit, të gjitha trajnimet në lidhje me këtë program janë zhvilluar në nivel universiteti dhe jo njësie kryesore/bazë”</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin e studimit të marrë në vlerësim është i kualifikuar, si dhe me përvojë të gjatë akademike dhe artistike. Sipas tabelës 6.1 (Dokumenti 22/ I.2.2 Tabela 6.pdf), vërehet se gjatë vitit akademik 2021-2022 janë angazhuar 9 PAE me nivel kualifikimi si vijon: 1 Prof.Dr; 2 Prof. asoc. Dr; 2 Dr., dhe 4 As. Lektor. Gjithashtu, janë angazhuar 6 PAK, me nivel kualifikimi, si vijon: 7 Dr., dhe 1 As.Lektor. Sipas RVB (2022), mësohet se <i>“Përveç titujve dhe</i></p>

qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

gradave shkencore, çka përbën garanci për aftësitë mësimdhënëse dhe formimin profesional-shkencor, personeli akademik është trajnuar herë pas here në aktivitete të llojit Master-Class-e, Work-shop-e etj, ku ka mundur të përditësojë, falë shembullit, formimin e tij artistik, shkencor sikurse dhe atë pedagogjik” (Dokumenti I/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).

Gjithashtu, personeli akademik ka përditësuar metodat e mësimdhënies duke përfshirë edhe teknologjinë informatike. Përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19, mësimi në Fakultetin e Muzikës u zhvilluar online nëpërmjet sistemit Windows Teams. Kjo përvojë krijoi mundësinë e rinovimit të mënyrës së mësimdhënies, qëkurse stafi akademik, sikurse dhe studentët përdorën metodologji të reja për mësimdhënien dhe mësimnxënien. (Dokumenti 83/ III.1.8. Udhezime dhe Kredencialet e Aksesit ne TEAMS - Platforma per mesimdhenien ne distance.pdf)

Bazuar në CV të personelit akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, vërehet se secili prej tyre është i mirënjohur në fushën e artit dhe kulturës, disa prej tyre edhe në arenën ndërkombëtare. Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik demonstroi një prodhimtari të admirueshme në fushën e veprimtarive artistike brenda dhe jashtë vendit, si dhe botimeve shkencore. (Dokumenti 82/III.1.7 CV me trajnimet e stafit akademik.pdf)

Nga krahasimi i të dhënave në dokumente lidhur me CV të personelit akademik dhe syllabuseve të lëndëve që ata zhvillojnë, rezultojnë një përputhje midis fushës akademike/specialitetit artistik dhe atij kërkimor të titullarit të lëndës/modulit dhe profilit të programit lëndor dhe studimor që ai zhvillon. Në të gjitha rastet, stafi akademik zotëron kompetenca dhe kualifikime në përputhje me lëndën përkatëse. (Dokumenti 82/III.1.7 CV me trajnimet e stafit akademik.pdf; Dokumenti 49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF).

UA/FM/ DKMDP respekton procedurën dhe kritere (të përgjithëshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin Rregullorë e UA (2021), Neni 92 i cili përcakton procedurat dhe modalitetet për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për t'i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programeve të studimit. (Dokumenti 16/ I.1.7. VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.pdf)

Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të

	<p>mësimdhënies interaktive me në qendër studentin, duke nxitur aftësitë e tyre krijuese dhe kritike, si dhe autonominë dhe qëndrimet e përgjegjëshme. Studentët treguan se ata komunikojnë lirshëm me pedagogët lidhur me mevojat e tyre për të nxënë, si dhe ndiejnë çdo ditë udhëheqjen, përkrahjen, mbështetjen dhe trajtimin e tyre me respekt nga ana e pedagogëve.</p> <p>Ndërsa personeli akademik, vuri theksin në një prej praktikave të mira të DKMDP, që mundëson studentin të zgjedhë paraprakisht pedagogun e lëndës së mësimi individual special duke përforcuar filozofinë udhëheqëse të UART dhe njërive të tij përbërëse për të vendosur studentin në qendër.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në dokumentin <i>“Rregullore e Funksionimit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në UART” (2021)</i>, Neni 2, mes të tjerash përcakton se përmes kësaj rregullore (SBC) ka për objekt vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit artistik shkencor. Në Nenin 12, specifikohet se <i>“Pyetësorët e stafit akademik dhe studentëve janë format e përdorëshme për realizimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, por jo vetëm”</i>. (Dokumenti 158/ VI.2.1. rregullore e NJSBC.pdf).</p> <p>Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, FM dëshmon se kryen në mënyrë periodike vlerësim dhe analizë të cilësisë së mësimdhënies duke përfshirë edhe studentët. (Dokumenti 63/II.5.5 pyetesor.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), vlerësimet dhe problematikat e pasqyruara në pyetësor, adresohen gjatë analizave dhe mbledhjeve në Njësinë Bazë dhe Grupet përkatëse Mësimore për t’u materializuar, nëse shihet e arsyeshme, nëpërmjet ndryshimeve në planet mësimore ose metodologji mësimdhënëse. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, dëshmon se kryen <i>analiza vjetore</i> ku merr në shqyrtim rezultatet e pyetësorëve me studentët të realizuara nga NJSBC, dhe reflekton mendimet dhe sugjerimet e tyre në procesin e përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies. (Dokumenti 51/ II.3.5. Raporti vjetor KMDP.pdf).</p> <p>Kjo përvojë tregon se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit, formave të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë, është pjesë e politikave dhe strategjisë së UART/FM/DI.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e</p>	<p>UART ka ngritur në nivel institucional strukturat përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Në statutin e UA (2021), Neni 136, shprehet se <i>“Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) funksionon pranë Sektorit të Kurrikulës dhe Informimit të Studentëve, dhe është përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë në UART dhe programeve të studimit që ofron. NJSBC është përgjegjëse për</i></p>

metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.

koordinimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë". (Dokumenti 12/I.1.2 Statuti i UART.PDF).

Gjatë vizitës në institucion dhe takimi i GVJ me personelin në përbërje të NJSBC-së, u mësua se kjo strukturë e bazon veprimtarinë e saj në Rregulloren përkatëse (Dokumenti 158/ VI.2.1. rregullore e NJSBC.pdf). KSBC dhe NJSBC promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me FM/DKMDP aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Në dokumentin "Kodi i Etikës së UA" (2020), Neni 5 "Përhapja e dijeve dhe liria akademike", në pikën 1, përcaktohet se "Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet artistike-shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t'i përmbahen përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë krijimin artistik-shkencor, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efektive, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët". (Dokumenti 89/III.3.6 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).

FM/ DKMDP dëshmon se mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Shëmbull i mirë në këtë drejtim është organizimi i masterclasse-ve nga profesorë të huaj ku personeli akademik të FM/ DKMDP ka pasur mundësi të ballafaqojë mësimdhënien e tij me atë të kolegëve homologëve nga universitete të huaja (Dokumenti 79/ III.1.4 Simaku, Bieti.pdf; Dokumenti 64/ II.5.6 Master-Class.pdf).

Sipas RVB (2022), institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë artistike. Njësia Bazë KMDP organizon çdo vit një sërë trajnimesh të cilat ofrohen për stafin akademik dhe për studentët. Në periudhën akademike 2019-2022, Njësia Bazë KMDP ka organizuar 9 trajnime dhe Master-Class të drejtuara nga pedagogë dhe artistë të ftuar nga vende të ndryshme. Falë këtyre trajnimeve, stafi akademik ka mundur të përfitojë nga eksperiencia e pedagogëve dhe artistëve të vendeve të ndryshme si Austri, Australi, SHBA, Itali dhe Spanjë. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).

Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se çdo pedagog është përgjegjës për rritjen e tij profesionale, rishikimin e programeve lëndore, përditësimin e literaturës, përmirësimin e metodologjisë së

	mësimdhënies, ekperimentimin me metoda të reja, cilësinë e krijimit artistik dhe shkencor, etj.		
Konkluzione	Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në FM, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master në UART (2021), Neni 12, midis të tjerash përcakton format e kontrollit të dijes të studentëve që sipas pikës 10 të këtij neni, “konkretizohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilat hartohen nga sekretaria mësimore mbi bazën e propozimeve të departamenteve. Grafiku i detyrimeve shpallet deri dy javë pas fillimit të semestrit”. Neni 17 i kësaj Rregullore, përcakton mënyrat e të provuarit të dijeve. (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Rregullore e Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022) është një dokument i posaçëm i hartuar nga FM/DKMDP, që në kreun V “Kontrolli i dijeve”, Neni 17, përcakton kriteret dhe mënyrën e të provuarit të dijeve dhe aftësive të studentëve, kreu VII “Praktika profesionale” përcakton mënyrën e organizimit dhe vlerësimit të komponentit të praktikës profesionale, dhe kreu VIII “Diplomimi” përshkruan modalitetet, standardet dhe rregullat e mbrojtjes së provimit të diplomës në përfundim të programit të ciklit të dytë Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi. Sipas Nenit 29, pika 1, ... Provimi i diplomës kryhet nëpërmejt paraqitjes së tezës së diplomës”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në këtë kuadër, DKMDP ka përgatitur edhe një Udhëzues për hartimin e diplomës/mikrotezës që orienton studentët në aspektin formal, teknik, gjuhësor, dhe në respektimin e rregullave bazë të shkrimit akademik përgjatë punimit të diplomës. (Dokumenti 102/ III.5.5 Udhëzues per diplomat.pdf).</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se Universiteti i Arteve, në kuadër të transparencës dhe të komunikimit me të interesuarit pasqyron në faqen e vet internet uart.edu.al çdo dokument lidhur me legjislacionin dhe rregulloret respektive me problematikat e jetës universitare. Informacioni është publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë studentët, përfshirë dhe ata që ndjekin studimet në programin MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Si pjesë e UART, personeli akademik i FN/ DKMDP zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “Për përhapjen e dijeve dhe lirisë akademike”, pika 4 që përcakton se “Personeli akademik duhet t’i shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit, duke e realizuar këtë nëpërmjet literaturës, bashkëbisedimit, leksioneve, demonstrimit artistik profesional sipas fushës së studimit, praktikës e provimeve”. (Dokumenti 89/II.3.6 vsa 23.1 KODI ETIKES.pdf).</p> <p>Rregullore e Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022), Nenin 17 “Mënyrat e të provuarit të dijeve”, përcaktohet se (3), “Modalitetet e vlerësimit të lëndës/modulit shprehen në syllabus”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në kategorinë “Forma e kontrollit të dijeve”, është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe artistike të studentëve. (Dokumenti 49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF; Dokumenti 35/II.1.4 syllabus pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Institucioni raporton në RVB (2022) se në fillim të çdo viti akademik, në orën e parë të mësimt, çdo pedagog sqaron studentët rreth përmbajtjes së lëndës, duke u përqëndruar në programin lëndor (Syllabusin), për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë që do të zhvillohen në kuadër të lëndës (leksione, ushtrime, seminare etj) • Format e kontrollit • Kushtet specifike për t’u pranuar në provimin përfundimtar • Raporti i vlerësimeve në funksion të rezultatit përfundimtar • Mënyrën e realizimit të formave të kontrollit <p>(Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas Rregullores Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 42 “Format e kontrollit”, shprehet se (1) kontrolli i dijeve mund të bëhet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Provimit me shkrim;</i> - <i>Provimit me gojë;</i> - <i>Vlerësimin të detyrave dhe të projekteve;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Kombinimi i tre formave të mësipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt;</i> - <i>Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special) konsiston në vlerësim të realizimit artistik profesional dhe teknik të programit.</i> <p><i>(6) Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit në fillim të semestrit. (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</i></p> <p>Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>						
Konkluzione	Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas Rregullores Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 42 <i>“Format e kontrollit”, pika 6 përcakton se “Forma e vlerësimit shprehet në planin mësimor të lëndës; mënyra e organizimit dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit në fillim të semestrit”.</i> (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), vlerësimi i studentit kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe shtrihet përgjatë gjithë vitit akademik. Mënyra e vlerësimit të studentit dhe pesha që zë secili element, si pjesë e shumatores së vlerësimit me notën përfundimtare, përcaktohen në programin e lëndës (syllabus).</p> <p>Referuar programeve lëndore (syllabuseve) të cilat zhvillohen në programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në veçanti kategorisë <i>“Kontrollit të njohurive”</i>, vërehet se janë përshkruar forma të tilla si: mbrëmje muzikore, saxho, kontroll teknik, esse, detyra, projekt, kolokium, provim, firmë, koncert, etj. Në tërësi, procesi i vlerësimit përfshin <i>kontrollin e vazhdueshëm të njohurive,</i></p>

	<p><i>kontrollin e ndërmjetëm dhe kontrollin përfundimtar.</i> Vlerësimi përfundimtar bazohet në disa elemente, kombinimi i të cilave varion sipas specifikës së lëndës/modulit, si: frekuentimi dhe diskutimi në seminar, detyra kursi dhe provimi përfundimtar; ose pjesëmarrja aktive në orën e mësimit, puna e pavarur krijuese, detyrat e kursit, projektet e kursit, provimi përfundimtar; ose ushtrime, praktika, esse dhe provimi përfundimtar; ose punë individuale, kontroll teknik, saxho dhe provim; ose pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim, punë individuale, ushtrim dhe provim përfundimtar; ose pjesëmarrje dhe angazhim në mësim, punë e pavarur, koncert dhe provim-koncert, etj. Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një rreze të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlllogaritet nga 30% – 80% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në note. (Dokumenti 49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF; Dokumenti 35/II.1.4 syllabus pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë si dhe ta ndihmojë atë hap pas hapi që të përmirësohet, si dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv. (Dokumenti 85/III.3.2 Menyra e vlerësimit te studentit.pdf)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk ka sistem elektronik për testimin dhe vlerësimin. Për të shmangur format e abuzimit dhe rritur transparencën për testimin dhe vlerësimin e studentëve, UART/FM/DKMDP zbaton procedura korrekte të përshkruara në rregulloret përkatëse, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Lëndët profesionale artistike me interpretim muzikor në kohë reale realizohen me prezencë publiku, pra, jo me dyer të mbyllura, duke shmangur kështu format e abuzimit ose subjektivizmit;</i> - <i>Lëndët teorike të cilat parashikojnë provimin me shkrim, në momentin e marrjes së tezës së provimit, sekretojnë emrin e studentit në mënyrë që komisioni i provimit të jetë sa më objektiv gjatë procesit të kontrollit dhe vlerësimit.</i> - <i>Vetëm pas kontrollit nga komisioni dhe vendosjes së vlerësimit, nga sekretaria bëhet zbulimi i emrit dhe vendosja e vlerësimit në listën respektive të studentëve.</i> - <i>Studentët kanë të drejtë të kërkojnë verifikim, në rast se nuk janë dakort me vendimin dhe vlerësimin e komisionit.</i> - <i>Rezultatet e testimit dhe vlerësimit të studentit/es, kanë një afat 5 ditor për komunikimin e rezultatit. Në vijim vendosen nga kryetari/ja e komisionit të provimit aktualisht në sistemin PITAGORA (ish ESSE3), duke ia bërë të njohur në kohë reale këtë rezultat studentit/es së interesuar.</i>

	(Dokumenti 13/L.1.3 Rregullore programi.pdf; III.3.4.Hedhja e notave tek Pitagora_Redacted.pdf; Dokumenti 90/III.3.7. fletë provimi e sekretuar.pdf)
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Sipas Rregullores Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Neni 41 “<i>Mënyrat e të provuarit të dijes</i>”, pika 3, shprehet se “<i>Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë, apo modul të caktuar merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, labororet, kontrollet e pjesshme, frekuentimi, etj. Shkalla e rëndësisë së secilit element në vlerësimin përfundimtar është e lidhur me peshën që zenë ato në ndarjen e kreditevetë lëndës sipas veprimtarive formuese të saj, të përcaktuara në planin mësimor dhe në programin e lëndës</i>”. (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), neni 17, pika (2) shprehet se “<i>Në rastin e organizimit të moduleve të përbëra ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë. Në të dyja rastet, vlerësimi përfundimtar shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë vlerësimi dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer. (3) Në syllabusin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit të saj</i>”. (Dokumenti 13/L.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022,) pedagogu i lëndës hedh në sistemin Pitagora, vlerësimin përfundimtar të studentit, në përputhje me parashikimet e rregullores së programit të studimit dhe programit të lëndës (syllabusit), bazuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimet e pjesëshme të sigurara përgjatë vitit akademik; 2. Vlerësimin e komisionit në provimin përfundimtar. <p>Vlerësimi i punimit të diplomës realizohet në përputhje me parashikimet e rregullores së studimit Neni. 33. Praktikave profesionale mësimore vlerësohen me notë nga pedagogu i ngarkuar me monitorimin e praktikave dhe koordinatori i institucionit pritës. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas RVB (2022), institucioni raporton se: <i>Kontrolli i dijeve dhe njohurive realizohet nëpërmjet krijimit të grupeve më të vogla mbështetur në rregulloren përkatëse dhe legjislacionin për institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Kjo metodologji, e kudogjendur në mbarë botën, mundëson kontaktin më të ngushtë mes pedagogut dhe studentit, duke krijuar mundësinë që të kontrollohen detyrat e çdo studenti në kohë reale, të mund të sugjerohen ndërhyrjet e mundëshme.</i> (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).

	<p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar shoqërohet me komente/feedback/ këshilla me qëllim që ta ndihmojë atë të përmirësohet në ardhmen.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 20, pika 9 shprehet se “Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve. Studenti që përdor forma dhe mjete të palejueshme, largohet nga provimi dhe konsiderohet vlerësuar negativisht”. Neni 29, pika 5, përcakton se “Punimi teorik i diplomës nuk duhet të përmbajë elementë të plagjiaturës. Për këtë arsye studentit duhet të vetëdeklarohet me shkrim mungesën e plagjiaturës në punimin teorik”. Neni 44, gërma (g) thekson se “Studentët duhet të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor ...” (Dokumenti 13/L.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, nga takim me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se plagjiatura apo kopjimi në provime mund të shmanget në FM, sepse stafi respekton dhe zbaton me korrektesë rregullat lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kushtet e sekretimit të tezës së provimit nga sekretaria mësimore, - monitorimin e procesit të provimit nga komisioni i përbërë nga pedagogë të lëndës, - moslejimin e përdorimit të së njëjtës tezë provimi me grupe që zhvillojnë provim në orare të ndryshme, - mospërsëritjen e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë edhe sezonin e riprovimit), etj., - sipas specifikës së lëndës, zhvillohet proces testimi duke luajtur koncert/musical live, <p>Përsa i përket shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik shprehet se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>FM/DKMDP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohë.</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 20, pika 10 përcakton se “Provimet me shkrim bëhen të sekretuara dhe zgjasin 2-4 orë ... Pika 11 specifikon se “Në të gjitha format e organizimit të provimit, studentit merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme, shtyrja e datës së dhënies së rezultatit bëhet me</p>

	<p>vendim të Dekanit”. Neni 21, pika 4 shprehet se “Në përfundim të provimit, kryetari i komisionit të provimit në praninë e anëtarëve të komisionit, bazuar në manualin e hedhjes së notave në sistem nga pedagogët, aksesohet në sistemin PITAGORA, në llogarinë personale dhe cakton në Proces Verbalin e Provimit digjital, vlerësimin e komisionit për secilin prej studentëve, në përputhje me Fletën e Provimit. Proces Verbali i Provimit shkarkohet nga kryetari i komisionit të provimit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët”. Pika 5 cilëson se “Proces Verbali i Provimit, i plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dhënies së provimit”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Në programin lëndor (syllabusin), në seksionin “Forma e kontrollit”, është përfshirë një tabelë e detajuar pikëzimi për vlerësimin e studentëve, të ndarë në kategori: nota numerike, nota me shkronja sipas ECTS, shkalla e suksesit të pikëve shprehur në %, përkufizimi/përshkrimi i notës me fjalë dhe shprehje. (Dokumenti 49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF; Dokumenti 35/II.1.4 syllabus pedagogji muzikore.pdf).</p> <p>Zbatimi me korrektesë i procedurave të marrjes në provim dhe kontrollit të dijeve, si dhe aplikimi i një sistemi të detajuar pikëzimi në vlerësimin përfundimtar të lëndës/modulit tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe afëtësive të studentëve janë të bazuara në meritë.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>UART/FM/DKMDP garanton bazuar në dokumentet rregullatore, të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës.</p> <p>Sipas Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore të Fakultetit të Muzikë (2021), Neni 45, pika 13 shprehet se “Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjen e dokumentuar apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur”. Pika 14 e këtij neni, përshkruan se “Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i njësisë bazë, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit”. Në pikën 15 specifikohet se “Studenti ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar për përgjigjen që ka dhënë ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e</p>

	<p>rezultatit, në Dekanat. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin, dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve". (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p>		
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore të Fakultetit të Muzikë (2021), Neni 45, pika 16 shprehet se "Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të jape përsëri provimin, me të njejtin komision ose me një komision të rid he nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve". (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Rregullorja mësimore e programit të studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" (2022), Neni 21, përcakton procedurat e dokumentimit dhe arkivimit të vlerësimit të studentëve, duke përfshirë dhe rastet e parregullsive të mundshme. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>		
Konkluzione	<p>UART/FM/DKMDP siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
			X

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta artistike e shkencore të studentëve.</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" (2022), Neni 1, "Programi i ciklit të dytë të studimeve është riorganizuar, për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të tregut, duke përfshirë në kurrikulën e tij edhe fushën e mësuesisë, duke ju mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndët e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm të ulët". Sipas përcaktimeve të Nenit 7 të këtij dokumenti, mes</p>

	<p>të tjerash theksohet se “Gjatë studimit të programit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, përpos zhvillimit të aftësive dhe pajisjen me kulturë muzikore në zhanre të ndryshme, synohet edhe rritja e kapacitetit të studentit në ilustrimin, verbal dhe me shkrim, të koncepteve bazë të teorisë së muzikës, teknikave analitike dhe aftësimin pedagogjik. Nëpërmjet pedagogjisë muzikore studenti merr informacionet dhe teknikat për dhënien e mësimin të lëndës së muzikës. Muzika e filmit, njohja me teknikat dhe muzikën pop, rock, jazz, informacionet mbi psikologjinë dhe historinë e muzikës kompletojnë formimin muzikor të mësuesit të ardhshëm të lëndës së muzikës. Bazuar në specifikën e programit, pjesa më e madhe e lëndëve dhe përmbajtja e tyre është hartuar në funksion të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”. Përmbajtja e programit të studimit vjen si vazhdimësi llogjike e programit të ciklit të parë Pedagogji Muzikore dhe synon thellimin e njohurive të studentit me kulturë muzikore dhe përgatitjen profesionale pedagogjike. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>UART/FM/DKMDP dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes investimit në teknologji (Dokumenti 117/ IV.2.3 aparaturat e studios.pdf; Dokumenti 147/V.3.1. publikimi i studios ne FB.pdf) dhe trajnimit jashtë orëve mësimore për të përdorur sistemin “Pitagorë” me qëllim realizimin e komunikimit elektronik. (Dokumenti 130/IV.4.3. PITAGORA - Manuali i Studentit.pdf)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik tregoi se studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë informatike ndërkohë që realizojnë detyra mësimore, ushtrime praktike të lëndëve speciale, apo kur zhvillojnë aftësi hulumtuese/ studimore artistike në fushën e muzikës dhe mësimdhënies.</p> <p>Sipas RVB (2022), mësohet se programi i studimit Master në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, materializon njohuritë e krijuara në ciklin e parë mbi teknologjinë e muzikës, për të cilën zhvillohet një lëndë e veçantë Elektroakustikë (Produksion Muzikor). Kjo lëndë thellohet me tej edhe në ciklin e dytë. Lëndët që aftësojnë komunikimin (Psikologji Komunikimi, Sociologji Muzikore), janë parashikuar mes lëndëve me karakter psiko-pedagogjik në funksion të aftësimin në mësimdhënie ku komunikimi mësimdhënës-nxënës është një ndër elementët thelbësor. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Në vijim të përmbushjes së kriterit 2, <u>GVJ sugjeron</u> që të përfshihet në planin mësimor një lëndë/modul dedikuar gjuhës së huaj (p.sh. gjuha e huaj angleze) me synim përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe</p>

	<p>ndërveprimet profesional në gjuhë të huaj të studentëve, në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe mobilitetit, të tilla si, projektet Erasmus+.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>DKMDP, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës. Në fund të semestrit, DKMDP kërkon nga pedagogu i çdo lënde apo moduli të raportojë në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës, si dhe të paraqesë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundëshme përfshihen në raportin e analizës vjetore të departamentit. (Dokumenti 51/ II.3.5. Raporti vjetor KMMDP.pdf).</p> <p>Kjo praktikë vlerësohet nga GVJ si një tregues pozitiv i angazhimit institucional për të inkurajuar personelin akademik të analizojë, shqyrtojë dhe reflektojë mbi objektivat përkatëse, të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen lëndore dhe metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të hartojë programe lëndore që thelbësisht synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p> <p>Në RVB (2022) institucioni raporton se “Në Fakultetin e Muzikës, për vet natyrën specifike të organizimit të mësimin në lëndët speciale mbështetur në VKM Nr.145 datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, studentët këshillohen në përfundim të çdo ore mësimi me qëllim përmirësimin e punës dhe arritjeve në fushën e interpretimit. Në përfundim të çdo semestri, çdo pedagog kryen analizën e punës së klasës së tij për të evidentuar arritjet dhe për përcaktuar detyrat për përmirësimin e punës për semestrin pasardhës. Në vazhdimësi, analizat zhvillohen në nivel grupi mësimor, departamenti dhe në dekanatin e Fakultetit të Muzikës”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se ata punojnë me studentin në mënyrë të tillë që të zhvillojnë kompetencat muzikore dhe pedagogjike të studentit, duke analizuar nevojat, potencialet dhe ecurinë e tij. Gjatë këtij procesi, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentin për zbatimin e detyrave akademike dhe artistike të kërkuara për çdo lëndë. Gjithashtu, stafi akademik tregoi se pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit, para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar. Në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe nxisin studentët të diskutojnë rreth mundësive për implementimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë</p>	<p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, është i kualifikuar dhe i prirur për të</p>

njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.

realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash, duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore (syllabuseve) dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritëshme të të nxëniet (në seksionin “*Qëllimi i lëndës*” dhe “*Korrelacioni me programin studimor*”) që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor. Gjenden shëmbuj të mirë të formulimit të rezultateve të pritëshme të të nxëniet, ku përdoren folje të matëshme, të tilla si: - të identifikojë, të dallojë, të krahasojë, të diskutojë, të demonstrojë, të përdorë, të shkruajë, të hartojë, të interpretojë, të realizojë, të planifikojë, të analizojë, të argumentojë, të vlerësojë, të aplikojë, etj., duke vënë theksin tek demonstrimi/përdorimi/aplikimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave në situata praktike. (Dokumenti 49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF; Dokumenti 35/ II.1.4 syllabus pedagogji muzikore.pdf)

Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik shpjegoi se leksionet, seminarët dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke ju dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme profesionale në situata praktike. Stafi akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: punë në grupe, diskutim, interpretim, analiza, reflektim, etj. Përsa i përket aspektit metodologjik të mësimdhënies, shumica e titullarëve të lëndëve treguan se ata kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxëniet e studentëve duke e bazuar në diskutime që nxisin mendimin kritik, kombinime të punës individuale dhe asaj në grup, ushtrime praktike ku gjejnë zbatim dijet e fituara, interpretimin artistik dhe zgjidhje të çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën.

Sipas RVB (2022), raportohet se “*zhvillimi i praktikave mësimore, parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara gjatë procesit mësimor në një kontekst praktik profesional. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione sipas parashikimeve dhe marrëveshjeve të arritura me institucionet arsimore. Universiteti i Arteve mbështet idetë inovative në art të studentëve, jep informacione bashkëkohore në fushën e artit dhe kulturës nëpërmjet interpretimeve e veprimtarive të ndryshme artistike si dhe duke rritur bashkëpunimin dhe mobilitetin e studentëve me institucione të tjera të arsimit të lartë*”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).

Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe

Personeli akademik efektiv dhe ose me kontratë i Departamentit të KMDP dëshmon se realizon interpretime artistike dhe diskutime të hapura për publikun mbi zhvillimet e reja të muzikës bashkëkohore, në evente koncertale, brenda/jashtë strukturës së programit të studimit

<p>teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”. (Dokumenti 76/ II.6.12 projekti trashëg kulturore jomateriale.pdf; Dokumenti 77/ II.7.2 aktiv 60 vjetori.pdf; Dokumenti 79 /III.1.4 Simaku, Bieti.pdf; Dokumenti 81 III.1.6 aktivitete, foto e mesimdhënies së pedagogëve në institucione të huaja.pdf; Dokumenti 96/ III.4.2. Leksion i Hapur.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), mësohet se “personeli akademik efektiv dhe me kontratë në Fakultetin e Muzikës dhe Njësinë Bazë KMDP, zhvillon vazhdimisht orë të hapura rreth avancimit të teknikave kompozicionale dhe rezultateve të punës së tyre kërkimore artistike. Këto aktivitete zhvillohen qoftë pranë Universitetit të Arteve e qoftë në institucione të tjera. ... E gjithë kjo veprimtari e ngjeshur artistiko-shkencore e cila zhvillohet jashtë strukturës së programit të studimit, shërben për studentët në veçanti por edhe për të gjithë pedagogët e tjerë si forma më efektive për të prezantuar zhvillimet dhe arritjet më të reja në fushën e mendimit, shkencës dhe artit në përgjithësi. Gjatë muajve Prill-Qershor 2022, në Fakultetin e Muzikës u realizuan mbi 60 koncerte me pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentë nga të gjitha departamentet e këtij fakulteti”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Gjithashtu, studentët pohuan gjatë takimit me GVJ se institucioni organizon veprimtari jashtë programit mësimor me karakter kulturor, shkencor dhe zbavitës.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka zhvilluar praktika të mira të dokumentimit të veprimtarive artistike/shkencore të planifikuara nga PA. Në rastin e organizimit të aktiviteteve pranë UART, Njësia Bazë KMDP merret me organizimin e mësimit të hapur, master-class-it etj. (Dokumenti 79 /III.1.4 Simaku, Bieti.pdf). Në rastet kur personeli akademik zhvillon veprimtari të ndryshme jashtë UART, pranë institucioneve të tjera, si rregull ai plotëson formularin e parashikuar pranë FM ku përcakton institucionin që e ka ftuar, llojin e aktivitetit, periudhën kur do të zëvendësojë orët e mësimit. (Dokumenti 97/III.4.3. Model leje pedagogu.pdf)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. FM/DKMDP inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore dhe artistike në bashkëpunim me pedagogët e tyre. GVJ evidentoi se institucioni mbështet bashkëpunimin me studentën në kuadër të ngjarjeve shkencore e artistike në nivel kombëtar/ndërkombëtar, organizuara nga UART/FM ose në partneritet me institucione të tjera, duke nxitur dhe mirëpritur pjesëmarrjen e studentëve në interpretime muzikore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. (Dokumenti 76/ II.6.12 projekti trashëg kulturore jomateriale.pdf; Dokumenti 77/ II.7.2 aktiv 60 vjetori.pdf; Dokumenti 79 /III.1.4 Simaku, Bieti.pdf; Dokumenti 81 III.1.6 aktivitete, foto e</p>

	<p>mesimdhënies se pedagoqeve ne institucione te huaja.pdf; Dokumenti 96/ III.4.2. Leksion i Hapur.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), mësohet se “Në Fakultetin e Muzikës është bërë traditë tashmë organizimi i aktiviteteve me krijimtari të studentëve e cila prezantohet dhe interpretohet nga vetë studentët. Fakulteti mbështet, nxit dhe inkurajon studentët të marrin pjesë në këto veprimtari duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e ideve inovative dhe kerkimore nga studentet”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se përsa i përket mbështetjes financiare nga ana e institucionit për zhvillimin e ideve inovative apo studimeve të përparuara kërkimore nga studentët, mbështetja institucionale realizohet në mënyrë indirekte, pasi investimet e kryera në nivel institucioni, u shërbejnë të gjithë studentëve krijues apo interpretë të cilët trajtojnë elementë të inovacionit dhe studimeve kërkimore në fushën e muzikës bashkëkohore.</p> <p>Sipas Rregullores së Universitetit të Arteve (2021), Neni 125 shprehet se “Veprimtaria e Këshillit të Studentëve të UART financohet dhe mbështetet nga buxheti i UART mbi bazën e parashikimeve në buxhet”. (Dokumenti 16/ I.1.7. VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.pdf)</p>		
Konkluzione	<p>Programi i studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>Institucioni ka hartuar dhe publikuar rregullore të posaçme për programin e studimit të marrë në vlerësim, dhe ndjek procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse para realizimit të tyre. Dokumenti Rregullore mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), është publik për të gjithë studentët. Në kreun VIII të këtij dokumenti “Diplomimi”, nga Neni 29 deri tek Neni 36, janë përshkruar procedurat e posaçme për detyrimet përmbyllëse. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Kriteret për fitimin e diplomës dhe procedurat e diplomimit janë përcaktuar edhe në dokumente të tjera të institucionit, si: Rregullore e</p>

	<p>Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës (2021), Rregullore e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Departamentit të Kompozicion – Muzikologji – Dirigjim – Pedagogji Muzikore (KMMDP) (2022), Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021).</p> <p>(Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf; Dokumenti 23/ I.2.3. 2022_VSA_44.pdf; Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>FM/DKMDP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>FM ka publikuar Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021) dhe Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi (2022) që përbëjnë dokumente rregullatore të posaçme të cilat përcaktojnë standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së dilomës për programin e ciklit të dytë të marrë në vlerësim. (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf; Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Gjithashtu, DKMDP ka përgatitur edhe një Udhëzues të posaçëm për hartimin e diplomës/mikrotezës, që lejon studentët të informohen rreth kërkesave teknike dhe standardet e punimit /mikrotezës së diplomimit. (Dokumenti 102/ III.5.5 Udhëzues per diplomat.pdf)</p> <p>Sipas Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 39, përcakton se (1) “Në Universitetin e Arteve ka një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitetet e ndryshme të procesit mësimor, etj. (2) Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma: (a) format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve; (b) në format elektronik në faqen zyrtare në rrjetë të UART i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët; (c) të shpallura në mjediset e Fakulteteve përkatëse.</p> <p>Bazuar në Nenin 40, të Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), FM/DI ka caktuar një Këshilltar Akademik për çdo student të programit të studimit, i cili është përgjegjës</p>

	<p>për të monitoruar ecurinë e studentit gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në UART, për ta orientuar, asistuar dhe këshilluar, etj., si dhe për të siguruar që studenti disponon të gjithë informacionin dhe dokumentacionin ndihmues përkatës. (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf)</p> <p>Sipas RVB (2022), raportohet se “Administrata e Fakultetit të Muzikës (kryesisht sekretaria mësimore), informon studentët për datat e zhvillimit të detyrimeve përmbyllëse në përputhje me parashikimet e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithëshme dhe asaj Mësimore në FM Neni. 44. Në rastet kur, për arsye objektive, ka ndonjë ndryshim në datën dhe orën e zhvillimit të provimit, sekretaria mësimor informon nëpërmjet postës elektronike, të gjithë studentët. Njoftimi i orarit, datës dhe vendit ku zhvillohet provimi përmbyllës, publikohet në vendet e caktuara në ambientet e FM dhe në web”. (Dokumenti 98/ III.5.1. Informime nga sekretari per ndryshime provimi.pdf; Dokumenti 99/ III.5.2. Model regjistrimi i studentit ne provim.pdf; Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni angazhon edhe një Specialist për Informimin e Studentëve, i cili siguron çdo informacion të nevojshëm në lidhje me procesin administrativ të zhvillimit të detyrimeve përmbyllëse.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në Rregulloren mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 29, pika 1, shprehet se “Në përfundim të programit të studimit, studentët diplomohen në programin Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”. Provimi i Diplomës kryhet nëpërmjet paraqitjes së tezës së diplomës”. Pika 6 e këtij neni shprehet se “Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një Mikroteze. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime shkencore në fushën përkatëse”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Sipas RVB (2022), mësohet se “Punimi teorik është organizuar në mënyrë që studenti të mund të argumentojë nga pikëpamja teorike-shkencore një tezë brenda një teme të caktuar, të vendosur paraprakisht më parë me pedagogun udhëheqës të temës. Komisioni i mbrojtjes së diplomës përbëhet nga pedagogë të këtij specialiteti, të cilët janë në dijeni dhe bazojnë vlerësimin e tyre në sa më sipër”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 32 specifikon se (3) Punimi i diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm, i</p>

	<p><i>përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të propozuar nga Departamenti i KMDP dhe të miratuar nga Dekani i FM. (4) Hartimi i tezës teorike të diplomës realizohet në përputhje me Shtojcën 3, dhe dorëzohet jo më vonë se 10 ditë përpara mbrojtjes së diplomes. (5) Mbrojtja e diplomës është publike.” (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 31, pika 6, shprehet se “Përgjegjësi i njësisë bazë bën propozimin e temave dhe programeve të diplomës, si dhe udhëheqësve, të cilat miratohen nga Dekani jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e fillimit të vitit akademik”. (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 31, shprehet se (1) “Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit dhe përcakton programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të çdo pike të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur realizimin me sukses të tezës/mbrojtjes në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. (2) Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. (3) Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit. Udhëheqësi mban shënimet përkatëse në lidhje me ecurinë e studentit në përgatitjen e tezës/mbrojtjes së diplomës. (4) Njësia Bazë KMDP organizon kontrole periodike, në të cilat kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e kryerjes së tyre. Përgjatë këtyre kontrolleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të tezës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit. (5) Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës. Udhëheqësi jep mendimin e tij dhe deklarohet se volumi i planifikuar i punës është kryer dhe studentit është gati për mbrojtjen e tezës së diplomës dhe më pas të mbrojtjes së saj”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni ndjek dhe dokumenton praktikën e përcaktimit të temës dhe mbrojtjes së diplomës, bazuar në rregulloren e programit të studimit, Neni 29, 30, 31, 32 dhe 33.</p> <p>Sipas RVB (2022), studentit diplomant dorëzon formularin e përcaktimit të temës së diplomës (Dokumenti 101/ III.5.4. Formular qe plotësohet nga studentit per diplomën.pdf) e cila duhet të firmoset nga udhëheqësi i diplomës, kryetari i grupit mësimor dhe përgjegjësi i Njesisë Bazë KMDP. Studentit i lihet koha e mjaftueshme për përcaktimin e temës së</p>

	<p>diplomës, kohë gjatë së cilës udhëheqësi dhe studenti konsultohen për përcaktimin e temës. Studenti, në konsultë me udhëheqësin, përcaktojnë temën e diplomës në përputhje me programin e Masterit Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi si dhe me interesat dhe prirjet e studentit. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p> <p>Bazuar në përcaktimet e mësipërme, dëshmohet se personeli akademik/udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi e asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuara. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>FM/DKMDP asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore dhe artistike. Sipas Rregullores Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 31, pika 4, shprehet se “<i>Në përcaktimin e temave/programeve të diplomës, njësisia bazë mund të bashkëpunojë dhe me institucione të tjera publike apo private që punojnë në fushat përkatëse</i>”. (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, autoritetet drejtuese treguan se FM/DKMDP u asiston studenteve brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në biblioteke, mjedis të mbuluar me WiFi, etj.</p> <p>Në RVB (2022), institucioni deklaroi se “Tema e diplomës në këtë program materializohet në kërkimin shkencor të studentit në biblioteka, arkiva, në organizmin e intervistave, pyetësorëve, sondazheve etj. Universiteti i Arteve mbështet punën e studentëve nëpërmjet arkivit të tij, bibliotekës së Universitetit ku gjenden shumë dokumente me vlerë që shërbejnë për parashtrimin teorik të punimit të temës së diplomës”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf)</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. Ky kriter gjen pasqyrim në Rregulloren Mësimore të Ciklit të Dytë të Studimeve Master në UART (2021), Neni 34, pika 1, ku deklarohet se “Në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit, mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë për çdo diplomant duke e nënshkruar atë. Komisioni pasi bën mesatarizimin e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe në prani të tyre, plotëson proces verbalin e provimit të diplomës. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkangjitet proces-verbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin regjistrohet nota përfundimtare dhe dorëzohet në</p>

	<p>sekretarinë mësimore të fakultetit.” (Dokumenti 18/I.1.9. VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.pdf; Dokumenti 100/III.5.3 procesverbal diplome.pdf)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Referuar Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 34, pika 1, përcakton se “<i>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës</i>”. (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p>Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai lëshohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), dhe përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit ...Përmbajtja dhe forma suplementit të diplomës përcaktohen në Statutin e UART, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. (Neni 102, Dokumenti 12/I.1.2 Statuti i UART.PDF)</p> <p>Sipas RVB (2022) raportohet se “<i>Në përfundim të studimeve, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës të miratuar nga senati akademik, hartuar në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 2.4.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës dhe listën e rezultateve të studimeve”. Diploma plotësohet në zbatim me Udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”</i>”. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf) Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se kopja zyrtare e programit të studimit, përfshin syllabuset e këtij programi. Ajo vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p> <p>Përmbushja e kriteri 7, dëshmohet edhe nga dokumentet që institucioni ka depozituar në e-ASCAL. (Dokumenti 102/III.5.5 Udhezues per diplomat.pdf; Dokumenti 104/III.5.7 diplome me suplement.pdf; Dokumenti 103/III.5.6.VSA25dt10032022.pdf).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UART/FM ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p> <p>Në RVB (2022), institucioni raporton se “<i>Informacioni i veprimtarisë akademike në UART ruhet në hardcopy dhe në formë elektronike. Ruajtja e dokumentacionit në letër (hardcopy) kryhet nga Arkiv-</i></p>

	<p>protokoll i UART, e cila është përgjegjëse për të gjithë dokumentacionin e Institucionit si dhe për korrespondencën shkresore institucionale dhe ndër institucionale... Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Muzikës, bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në Universitetin e Arteve, Neni 6, ruan dokumentacionin e studentëve në Regjistrin e Themeltar dhe Regjistrin e Arritjeve ... Në përfundim të diplomimit dhe vlerësimit pozitiv, një kopje e diplomës së studentit i dërgohet Bibliotekës së Universitetit të Arteve e cila e ruan në arkivat e saj. I gjithë dokumentacioni i studentit është i mundshëm për të verifikuar sipas rastit dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 (i ndryshuar) "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf; Dokumenti 106/III.5.9 regjistri themeltar.pdf; Dokumenti 148/ V.4.1. Statistikat e regjistrimeve dhe te Diplomuarve.pdf; Dokumenti 149/ V.4.2 Foto nga regjistri i arritjeve.pdf)</p> <p>Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi kjo strukturë e FM disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve nga momenti i aplikimit deri tek diplomimi, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Rregulloren e Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART (Dokumenti 105/ III.5.8.VSA Nr_ 23, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit te Sekretarive Mesimore te Fakulteteve, ne UART.pdf) dhe procedurat përkatëse mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë të të dhënave personale. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, një kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore. Nga takimi me drejtuesin e Departamentit të KMDP, u dëshmuua se kjo njësi ruan kopjet e dorëzuara të punimit të diplomave që studentët mbrojnë para komisionit, në version hardcopy dhe elektronikisht (CD).</p>						
Konkluzione	Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="566 1720 762 1803">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="762 1720 965 1803">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="965 1720 1417 1803">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="566 1803 762 1859"></td> <td data-bbox="762 1803 965 1859"></td> <td data-bbox="965 1803 1417 1859" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.6
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>FM/DKMDP në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, dëshmon se garanton mjedise brenda dhe jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e ushtrimeve/detyrave artistike dhe praktikës profesionale të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të vëzhgonte disa nga klasat për mësim special, sallat e leksionit/seminareve, laboratorin “Çesk Zadeja”, studion teknologjike, etj., ku studentët e programit të studimit të marrë në vlerësim, zhvillojnë mësim praktikë dhe ushtrohen me instrumente. FM ka në dispozicion të stafit dhe studentëve edhe repartee shërbimi, si: reparti ndihmës dhe shërbimit për mësimdhënien dhe reparti ndihmës dhe shërbimit për labororet (riparim të veglave muzikore). (Dokumenti 116/ IV.2.2 Ambientet ne FM.pdf; Dokumenti 117/ IV.2.3 aparaturat e studios.pdf; Dokumenti 147/ V.3.1. publikimi i studios ne FB.pdf)</p> <p>Sipas RVB (2022) institucioni deklaron se: <i>“Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve të arsimit para universitar nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti KMDP. Zhvillimi i tyre bazohet në aktmarrëveshjen ndërinstytucionale ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës pale”</i>. (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf; Dokumenti 29/1.3.5.Nenshkrim marreveshje praktika mesimore.pdf; Dokumenti 30/ 1.3.6. Relacion mbi praktiken mesimore per vitin akademik 2021-2022.pdf; Dokumenti 45/II.2.3 vleresim praktike mesimore.pdf; Dokumenti 52/ II.3.6 model dosjeje praktike mesimore.pdf; Dokumenti 71/ II.6.7 praktika ne shkollen Zyber Halluli.pdf; Dokumenti 6/ 2.1 zhvillimi i praktikes me Bashkine Tirane.pdf)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>UART/FM/DKMDP, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave profesionale me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale të studentëve të programit të studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi.</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” (2022), Neni 28, shprehet se (3) <i>“Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve të arsimit para universitar nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti KMDP. Zhvillimi i tyre bazohet në aktmarrëveshjen ndërinstytucionale ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces. (4) Personeli Akademik që e drejton atë, mban lidhje me</i></p>

	<p><i>Institucionin ku ajo kryhet për secilin student.</i> (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf).</p> <p><i>Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve të arsimit para universitar nën drejtimin e Personelit Akademik të caktuar nga Departamenti KM DP. Zhvillimi i tyre bazohet në aktmarrëveshjen ndërinstytucionale ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës pale</i>". (Dokumenti 1/ RVB Pedagogji Muzikore dhe mësuesi.pdf; Dokumenti 29/I.3.5.Nenshkrim marreveshje praktika mesimore.pdf; Dokumenti 30/ I.3.6. Relacion mbi praktiken mesimore per vitin akademik 2021-2022.pdf; Dokumenti 45/II.2.3 vleresim praktike mesimore.pdf; Dokumenti 52/ II.3.6 model dosjeje praktike mesimore.pdf; Dokumenti 71/ II.6.7 praktika ne shkollen Zyber Halluli.pdf; Dokumenti 6/ 2.1 zhvillimi i praktikës me Bashkinë Tirane.pdf)</p> <p>Sipas Ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", Neni 8, pika 1, të diplomuarit në programin e studimit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, kandidatë për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit, duhet: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në UP-në përkatëse, që në rastin e mësuesit janë Drejtoritë Arsimore Rajonale. https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRR1.pdf</p> <p>(Dokumenti 58/ II.4.6 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-MESUESIT.pdf)</p>
<p>Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Në dokumentit "Rregullore e veprimtarisë së përgjithëshme dhe mësimore të Fakultetit të Muzikës" (2021), Neni 28, pika 3, shprehet se "Për mbikqyrjen e zhvillimit të praktikës mësimore, përgjegjësi i departamentit emëron pedagogun që do të ndjekë, vlerësojë dhe plotësojë dokumentacionin e praktikës mësimore ..." (Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf).</p> <p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi" (2022), Neni 28, shprehet se (2) "Praktika mësimore është pjesë e kurrikulës mësimore për programin e studimit, Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi" dhe përmban një numër kreditesh të caktuara". (5) "Në përfundim të praktikës profesionale, studenti vlerësohet me notë ose me vlerësimin pozitiv/negativ sipas përcaktimit në sylabusin e lëndës". (Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf; Dokumenti 30/ I.3.6. Relacion mbi praktiken mesimore per vitin akademik 2021-2022.pdf; Dokumenti</p>

	45/II.2.3 vleresim praktike mesimore.pdf; Dokumenti 52/ II.3.6 model dosjeje praktike mesimore.pdf;).			
	Referuar Planit Mësimor (2021-2022), praktika mësimore përfshin 6 kredite. (Dokumenti 32/II.1.1 Plan mesimor MP pedagogji muzikore.pdf).			
Konkluzione	Në rastin e programit të studimit “Master Profesional” në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale dhe stazhit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në RVB e programit të studimit si dhe gjatë vizitës në institucion, konstatohet që personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, në vitet 2020-2021 dhe 2021-2022, respekton kriteret ligjore në fuqi, si dhe ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies. Stafi akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies në programin e studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi i përmbahet kërkesave të parashikuara në Ligjin 80/2015, VKM Nr. 29, datë 10.09.2018, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, VKM, Nr. 145, datë 10.03.2021 dhe Kodit të Punës. Përpos parashikimeve ligjore, për vetë natyrën e veçantë të programit të studimit, Njësia Bazë KMDP vlerëson eksperiencën shkencore/artistike të stafit akademik në funksion të lëndës/ve për të cilat materializohet angazhimi. Në programin e studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi, për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në total, me kohë të plotë dhe të pjesëshme, 17 pedagogë, prej të cilëve:

	<ul style="list-style-type: none"> • 3 nga kategoria Profesor • 9 nga kategoria Lektorë • 5 Asistent Lektor (bazuar në specifikën e programit të studimit dhe statusin e veçantë të UART dhënë me VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë) <p>Referencë: -Cv e personelit akademik -Tabelat e stafit akademik për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</p> <p><i>Evidenca: Tabelat Personeli. Evidencë I.2.1</i> <i>Evidenca: Udhëzimi Nr.29 dt.10.9.2018</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatuam se, personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të KMDP-së, mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdhënës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konform Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi nuk e mbulon 100% ngarkesën e detyrueshme mësimore sipas kategorisë të cilës i përket, në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. Gjithashtu, referuar VKM së mësipërme Pika II, Numër 1, stafi akademik në marrëveshje me drejtuesin e Njesisë Bazë KMDP dhe, kur është e nevojshme, me miratimin e dekanit të Fakultetit të Muzikës, merr përsipër realizimin e orëve suplementare në auditor ose mbikqyrjen e praktikave mësimore/profesionale. Stafi akademik efektiv në programin Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mesuesi nuk e realizon 70% të orëve në auditor, parashikuar për kete program. Kjo për shkak se një nga lektorët e këtij programi është larguar për të kryer detyra të rëndësishme shtetërore bazuar në Ligjin e arsimit të Lartë Nr. 80/2015, neni 65.</p> <p>Referencë: <i>Evidenca: Tabelat Personeli. Evidencë I.2.1</i> <i>Evidenca: Udhëzimi Nr.29 dt.10.9.2018</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat</p>	<p>Bazuar në takimin me Drejtorinë e burimeve njerëzore konstatuam se, institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore të stafit akademik dhe të studentëve që zhvillojnë praktikat mësimore pranë shkollave përkatëse.</p>

<p>e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjithashtu, në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektësi në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca:</i> Dokumenti 58/ II.4.6 Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-MESUESIT.pdf)</p> <p>-Kopje e një modeli marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik -Model draft kontrate të stafit akademik me kohë të pjesshme -Model kopje listpagese me sigurimet e paguara</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, resulton se, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të <i>Departamenti KMDP</i>. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.</p> <p>Institucioni ndjek procedurat rekrutimi dhe vlerësimi sipas kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara në konkurs. si rregull, procedurat e rekrutimit, kanë dy pjesë: kriteret e përgjithshme dhe ato specifike.</p> <p>-Kriteret e përgjithshme hartohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore.</p> <p>-Kriteret specifike parashikohen nga Njësia Bazë KMDP. Në hartimin e kriterëve specifike, Njësia Bazë KMDP parashikon specifikime në përputhje me :</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Lëndën/ët për të cilat do të angazhohet stafi akademik; b) Kategorinë e stafit akademik të kërkuar <p>Referuar RVB-së, resulton se, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të <i>Departamenti KMDP</i>. Bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca:</i> I.2.1 Tabelat Personeli per programin Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</p>

	<p>Evidenca: II.6.10 Tabelat Personeli per programin Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</p> <p>Evidenca: IV.1.4 Tabelat Personeli per programin Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</p> <p>Evidenca: IV.1.5 Tabelat Personeli per programin Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</p> <p>Evidenca: IV.1.6 Tabelat Personeli per programin Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</p> <p>-Model dosje për rekrutim personeli akademik</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UART mbështetur në Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë përcakton organizimin e brendshëm akademik si dhe administrativ të tij.</p> <p>Bazuar në RVB, dhe vizitën në institucion, konstatuam se, Fakulteti i Muzikës ka punonjës ndihmës për realizimin e këtij programi studimi në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore si dhe në realizimin e aktiviteteve artistike dhe mësimore, për vetë natyrën specifike të këtij programi studimi, si: Struktura administrative dhe ndihmës akademike në Fakultetin e Muzikës përbëhet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ: <ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria e Fakultetit të Muzikës Kryesekretarja Specialisti për kurrikulën dhe informimin e studentëve • Struktura administrative: <ul style="list-style-type: none"> - Kryetari i Degës së FM - Punonjësit e shërbimit. • Struktura ndihmës akademike me karakter akademik: <ul style="list-style-type: none"> - Specialistët (laborantët) e Fakultetit të Muzikës <p>Referencë:</p> <p>-Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, Institucioni mbledh dhe ruan të dhënat e personelit akademik në dosjet e personelit. Të dhënat mblidhen, ruhen dhe përditësohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, - angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik,

<p>organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - angazhimin e çdo anëtari të personelit ndihmës dhe administrativ. - Personeli akademik me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar, aplikon çdo fillim viti akademik. - Kriteret e konkurrimit shpallen publikisht sipas legjislacionit në fuqi. <p>Referencë: <i>Evidenca: Dokumenti 12/1.1.2 Statuti i UART.pdf .2021</i> <i>Evidenca: Organigrama FM Organigrama FM (2).</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM Nr. 329 datë 12.4.2017 Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik - Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018, - Kopje e një modeli marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik sipas grupeve mësimore.
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë, duhet të realizojnë praktikat mësimore pranë një institucioni të arsimit parauniversitar. Institucioni “UART” ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe ZVA dhe institucione të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht, FM ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Zyrat arsimore, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor. UART merr përsipër: deklarimin e studentëve praktikantë lidhur me sigurimet shëndetësore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës.</p> <p>Njësia Bazë KMDP, përcakton një ose disa pedagog, në varësi të numrit të studentëve sipas parashikimeve të Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 Pika II, Numër. 12, gërma e, për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritës.</p> <p>Zyrat arsimore, marrin përsipër, mundësimin e zhvillimit të praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë. Gjithashtu, çdo studenti i caktohet një pedagog për udhëheqjen e diplomës. Në përfundim të vitit akademik, udhëheqësit të diplomës i njihet realizimi i ngarkesës në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Referencë: <i>-Kopje e marrëveshjes për praktikat profesionale me ZVA Vlorë</i> <i>-Model vlerësimi i praktikës profesionale.</i></p>

	<p><i>Evidenca: Marreveshje FM me ZVA Vlore.</i></p> <p><i>Evidenca: Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022 "Rregullorja per zhvillimin e praktikave-profesionale-te-mesuesit".</i></p>		
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Formularët dhe dosja e praktikës janë pjesë përbërëse e vlerësimit final të studentit, si dhe paraqesin në mënyrë të qartë veprimtarinë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuar përgjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022 Rregullorja per zhvillimin e praktikave-profesional-te-mesuesit.</i></p> <p><i>-Model vlerësimi i praktikës profesionale.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Promovimi i personelit akademik deri më tani ka qenë i pamundur, qëkurse Universiteti i Arteve, për shkak të mos pasjes së Ciklit të tretë të studimeve, nuk ka ngritur Komisionin për promovimin e Personelit Akademik. Me çeljen e programeve të doktoratës në vitin akademik 2022- 2023, ka nisur puna për ngritjen e komisionit të sipërpërmendur çka sigurisht që do të reflektohet në promovimin e mëtejshëm të personelit akademik dhe rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor/artistik.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi gjithashtu, se zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DI dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program.</i></p> <p><i>Konstatuam se realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës.</i></p> <p><i>Përsa me sipër, ky standard plorësohet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e</p>	<p>Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se, Infrastruktura e UART është e përshtatshme për përmbushjen e nevojave të mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike, kërkimore – shkencore. Një</p>

<p>veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>pjesë e lëndëve që zhvillohen në ambientet e sipërpërmendura, bazuar edhe në planet mësimore të disa programeve të tjera, zhvillohen bashkërisht me studentët e programeve Muzikologji dhe Mësuesi, Dirigjim dhe Mësuesi, Kompozim dhe Mësuesi, programet e ciklit të dytë të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe të programit të ciklit të dytë të Fakultetit të Artit Skenik. Për lëndët të cilat zhvillohen së bashku me studentët e programeve të tjera të studimit, përpos atyre të sipërpërmendura, institucioni vë në dispozicion salla me kapacitete të shtuara sikurse është Lektoriumi “Tonin Harapi” dhe salla Black Box.</p> <p>Referencë: --Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete e duhura elektronike dhe teknologjike, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, si dhe veprimtaritë artistike përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit.</p> <p>Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përbushur kështu standardet e duhura për çdo student.</p> <p>Referencë: --Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga vizita e mjedisëve, konstatoam se, Laboratorët dhe studiot janë të pajisura me aparaturat e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi. Aparaturat e studiove përmbushin të gjitha kriteret për formimin teorik dhe materializimin praktik të objektivave të lëndëve në programin e studimit.</p> <p>Referencë: --Vizita e GJV-së në Universitetin e Arteve</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se Fakulteti i Muzikës, përpos, sallës së Bibliotekës së UART, të pajisur me PC dhe programe profesionale, zotëron në ambientet e tij dy Laboratorë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale.</p> <p>Në laboratorin 1 ndodhen 5 kompjutera të pajisur me programin Sibelius (për notëzimin digjital) dhe Steinberg Cubase (për regjistrim dhe përpunim audio), ndërkohë që në Laboratorin e Tingullit (studio e muzikës elektroakustike) është mundësuar implementimi i një studioje të mirëfilltë regjistrimi dhe përpunimi audio e pajisur me 1 kompjuter Macintosh të gjeneratës së fundit,</p>

	<p>mikser digjital, sistem audio 5:1 (surround), procesorë për përpunimin e tingullit (Reverb, Compressor, etj) sikurse dhe me programet kompjuterike (Steinberg Cubase Pro, Logic Pro, Max MSP)</p> <p>Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UART, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidenca: Infrastruktura IT e UART</i></p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Konfirmojmë që, Praktikat profesionale e zhvilluara në kuadër të programit të studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi, zhvillohen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. Në lidhje me këtë të fundit, Fakulteti i Muzikës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Evidenca: Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022 Rregullorja per zhvillimin e praktikave-profesionale-te-mesuesit.</i></p> <p><i>Evidenca: Evidenca I.3.5. Marreveshjet. (Dokumenti 28/I.3.4 Marreveshje bashkepunimi.pdf; Dokumenti 29/I.3.5.Nenshkrim marreveshje praktika mesimore.pdf).</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj artistike.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatohet se institucioni ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përbushet plotësisht.</i></p>						
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale)</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një</p>

<p>garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit si dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme artistike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatuam se, literatura për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga: Literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të programit të studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi, parashikohet në programin (syllabusin) e çdo lënde. Disponimi i literaturës bazë dhe ndihmëse parashikohet në përputhje me Rregulloren e FM, Neni 13, pika 9. Rrjedhimisht studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara :</p> <ol style="list-style-type: none"> a) fizikisht (hard copy) në Bibliotekën e UART; b) të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), në rastin e leksioneve të hartuara; c) nëpërmjet paraqitjes së linkut ku mund të gjendet materiali i parashikuar. <p><i>Evidenca: Katalogu online i BSHUA.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatohet se, Njësia Bazë KMDP, në fillim të çdo viti akademik, njofton pedagogët e lëndëve për afatet e rishikimit të programeve të lëndëve (syllabuset). Së bashku me rishikimin e programit të lëndës, nëse ka, pedagogu ka mundësinë e rishikimit dhe përditësimit edhe të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse. Për më tepër, Njësia Bazë KMDP, nisur nga propozimet e pedagogëve të lëndëve dhe hulumtimet e kryera veçmas parashikon përditësimin e literaturës dhe pasurimin me materiale (libra, artikuj etj).</p> <p><i>Evidenca II.4.1: Katalogu i partiturave të dhuruara BSHUJ nga shtëpia botuese gjermane Henle Verlag</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, biblioteka është e konceptuar në disa mjedise të ndërlidhura së bashku. Përveç mjedisit ku është vendosur fondi i librave, gjenden gjithashtu edhe dy salla laboratorë si: Salla e fondit të hapur dhe Media Library të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik.</p> <p>Në ambjentet e bibliotekës ndodhet gjithashtu salla “Multimedia”, e cila është e pajisur me 20 kompjutera që kanë akses në internet të pajisur me softëare specifik në mbështetje të punës individuale studimore.</p> <p>Shërbimi elektronik i bibliotekës ofrohet nëpërmjet dy sistemeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i menaxhimit përmes të cilit biblioteka kryen katalogimin dhe shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) për audiencën e gjërë.

	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i arkivit digjital ku përdoruesit mund të shfletojnë materialet elektronike. <p>Studentët, përveç kartelës fizike, tashmë kanë mundësinë edhe të qasjes nëpërmjet kartelës elektronike.</p> <p>Verifikimi i materialeve të BSHUA mund të bëhet edhe online, përpara se të kërkohet disponimi i materialit.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=344&niveli=60</p> <p><i>Evidenca: Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se, Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit.</p> <p>Biblioteka e UART luan rolin e një biblioteke speciale për të gjithë fishat e artit në Shqipëri.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se • Biblioteka Shkencore e Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve, zotëron koleksionet unike të artit muzikor të materializuara në libra, parte, dorëshkrime, dizertacione, diploma teorike, periodikë, referenca, materiale audiovizuale, literature elektronike, etj. Fondi i Bibliotekës përmban në total mbi 45,000 tituj. Biblioteka e UART zotëron rreth 1000 CD, 800 Pllaka gramafoni, 600 Kaseta, 600 Shirita dhe mbi 1400 partitura dhe parte të formacioneve orkestrale. Në funksion të dokumentimit të materialeve në diposozicion, BSHUA mban regjistrin themeltar me të dhënat e të gjitha hyrjeve në bibliotekë qysh prej krijimit të saj. Në tërësi BSHUA disponon 16 regjistra të tillë sipas materialeve të administruara.</p> <p><i>Evidenca: Katalogu online i BSHUA në www.uart.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka Shkencore e UART, si njësi kryesore e mundësimit të literaturës shkencore dhe artistike, krijon mundësi të barabarta për të gjithë studentët e institucionit. Salla multimediale e Bibliotekës të UART, e pajisur me teknologjinë e kohës, është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, dhe studiuesve të artit, tërësisht pa pagesë. Statistika për përdorimin e kompjuterëve (disponojnë programe specifike sipas degëve të artit) të sallës multimediale nga përdoruesit e bibliotekës për nevojat e tyre mësimore dhe artistike është afërsisht nga 90 – 100 përdorues në ditë. Kjo sallë përveç arkivës digjitale, disponon edhe materiale të tjera audiovizuale në</p>

	<p>shirita në bobina, pllaka gramafoni, kasete, CD e DVD. Arkiva digjitale e aksesueshme e kësaj salle është krijuar nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve me bazë "kod me burim të hapur". Qëllimi i kësaj arkive është që të ofrojë akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar për të gjithë audiencën e Bibliotekës së UART. Çdo student gëzon të drejtën e konsultimit online të BSHUA duke hapur një llogari personale dhe të shfrytëzimit të atyre materialeve të cilat BSHUA i ka tashmë të digjitalizuara. Njëherazi BSHUA njofton stafin akademik dhe, nëpërmjet tyre studentët, për mundësitë e aksesimit të bibliotekave ndërkombëtare online. GVJ vlerëson mundësinë e ofruar për studentet nga Institucioni për përdorimin e bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca:</i> http://arkiv.uart.edu.al</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Rezultoni se, Biblioteka e UART është e pajisur me teknologjinë e nevojshme në funksion të kërkesave të programit të studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi. Në ambientet e bibliotekës ndodhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Salla Multimediale” e cila është e pajisur me 20 kompjutera me qasje në internet të pajisur me software specifik në mbështetje të punës studimore në fushën e muzikës. Njëherazi në këtë ambient ndodhet edhe pajisja (Rack-u) i përbërë nga pjesa më e madhe e aparaturave për riprodhimin audio (kasetë, dat, CD). • Salla e fondit të hapur e pajisur me 4 kompjutera për përdoruesit. • Zyra e përpunimit të informacionit pajisur me 6 kompjutera. • Ambienti i konsultimit të dedikuar për katalogun online pajisur me 2 kompjutera. • Të gjithë studentët gëzojnë të drejtën e qasjes në ambientet e bibliotekës sipas orarit zyrtar. <p><i>Evidenca:</i> uart.edu.al/katalog_biblio <i>Evidenca:</i> http://imslp.org/ <i>Evidenca:</i> arkiv.uart.edu.al</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatoam se, Biblioteka funksionon në bazuar në përcaktimet e Statutit të UART Neni. 21 dhe rregullores së bibliotekës. Në përputhje me sa më sipër, BSHUA, bazuar në rregulloren e saj Neni. 18 qëndron e hapur çdo ditë të javës duke nisur prej orës 08:00-19:00 me përjashtim të ditës së Premte gjatë</p>

<p>përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>së cilës orari i BSHUA parashikohet të jetë 08:00-16:00. Orari i BSHUA është organizuar në mënyrë të tillë që t'i përshtatet veçorisë mësimore dhe studimore në programet e studimit në UART, ku përpos zhvillimit të mësimi, një pjesë e madhe e studentëve kanë nevojë për ambientet e institucionit në funksion të përgatitjes së lëndëve të ndryshme. Në mënyrë të veçantë, përgjatë sezoneve të provimeve, biblioteka e UART, për të plotësuar kërkesat e shtuara të studentëve dhe stafit akademik, punon me orar të zgjatur, bazuar në kërkesat e Fakulteteve të UART.</p> <p><i>Evidenca:</i> uart.edu.al/katalog_biblio</p> <p><i>Evidenca:</i> arkiv.uart.edu.al</p>		
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatojmë se, Biblioteka e UART informon rregullisht Njësitë Bazë për gjendjen e fondit, ambientet, shtimin e mundësive nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjisë etj. Gjithashtu, BSHUA paraqet edhe raporte në lidhje me frekuentimin e saj. Për më tepër, njësitë përgjegjëse informohen për mundësitë dhe fondet e vëna në dispozicion të pasurimit të literaturës. Bazuar në njoftimin e bibliotekës, Njësia Bazë KMDP paraqet kërkesat e saj për literaturën e nevojshme dhe pasurimin e fondit të bibliotekës në funksion të programit të studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi</p> <p><i>Evidenca:</i> uart.edu.al/katalog_biblio</p> <p><i>Evidenca:</i> arkiv.uart.edu.al</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se, Biblioteka e UART ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe dorëshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore të programit Master Profesional në "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht..</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të</p>	<p>Universiteti i Arteve siguron menaxhimin e informacionit dhe të dhënave për studentët dhe stafin akademik nëpërmjet:</p>

<p>cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>a) web-it të UART (http://www.uart.edu.al/)</p> <p>b) Komunikimit nëpërmjet postës elektronike (të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe studentët depozitojnë pranë sekretarisë mësimore adresën e postës elektronike);</p> <p>c) Sistemit të brendshëm PITAGORA (të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe studentët janë të aksesuar në sistemin e sipërpërmendur.</p> <p>Gjithashtu, konstatojmë që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik; • të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik; • të dhënat e studentëve që diplomohen. <p>Njësia Bazë KMDP punimet e temave dhe detyrave të kursit ruhen pranë Njesisë Bazë. Për më tepër, aktivitetet e realizuara nga studentët publikohen në faqen web dhe rrjetet sociale të UART.</p> <p>Referencë: <i>Evidenca: Manual - studenti ne sistemin Pitagorë.</i> <i>Evidenca: Manual_Pedagogu ne sistemin Pitagore.</i></p> <p>Platforma online http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=963&niveli=68</p> <p>-Njoftime http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=69</p> <p>-Pranimet në UART http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=133&niveli=75</p> <p>-Pajisja me Diplomë http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=134&niveli=77</p> <p>-Drejtoria e BNJ dhe Informacion, Protokoll dhe Arkivë http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=110&niveli=5</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin</p>	<p>Institucioni posedon marrëveshjen për kohën vjetore të punës, dosjen e personelit akademik, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përditësimit të të dhënave të dosjes individuale

<p>dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - përditësimin të të dhënave të aktivitetit akademik dhe kërkues artistik – (akt marrëveshja për kohën vjetore të punës me dokumente mbështetës) personelit ndihmës akademik, përmes: - përditësimin të të dhënave të dosjes individuale - përditësimin të të dhënave të veprimtarisë ndihmëse akademike me karakter mësimor, artistik, shkencor dhe veprimtarisë ndihmëse akademike me karakter administrativ <p>personelit administrativ përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përditësimin të të dhënave të dosjes individuale - përditësimin të të dhënave të veprimtarisë administrative <p>partnerëve të angazhuar (personelit akademik të ftuar, me kohë të pjesshme) përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përditësimin të të dhënave të dosjes individuale, CV dhe dokumentacionit shoqëruës. <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një model akt marrëveshje për kohën vjetore të punës - Një model dosje të aktivitetit ndihmës akademik me karakter mësimor, artistik e shkencor - Një model dosje të aktivitetit ndihmës akademik me karakter administrativ.
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sigurimi i informacionit, për personelin akademik dhe studentët, realizohet nëpërmjet sistemit PITAGORA të implementuar pranë Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve Tiranë. Studentëve dhe pedagogëve ju është mundësuar një Manual për përdorimin e këtij sistemi. Ky sistem siguron një sërë të dhënash si:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marrë dhe librezën e notave; b) Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët; c) Njoftimin në kohë reale të notave apo mënyrave të tjera të vlerësimit të studentëve. <p>Njëherazi, nëpërmjet web-it të Universitetit të Arteve, është i mundur sigurimi i informacionit dhe dokumentacioneve të nevojshme për studentët dhe stafin akademik..</p> <p>Reference: Evidenca: <i>Rregullore e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i> <i>-Model i të dhënave të përgjithshme dhe/ose regjistrimit të të dhënave të studentëve lidhur me frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, vlerësimin, gjenerimin e procesverbalit të provimit në sistemin PITAGORA</i></p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit PITAGORA, PITAGORA është një platformë e cila siguron këmbimin e informacionit mes studentit dhe pedagogut. Nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi i pedagogut për studentin në një lëndë specifike, pasqyrohet në kohë reale në adresën personale të studentit brenda të njëjtit sistem (shih Evidenca III.3.4).</p> <p>Ky sistem siguron një sërë të dhënash si:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marrë dhe librezën e notave; Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët; <p>Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh.</p> <p><i>Referencë:</i> <i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i> <i>Evidenca: Rregullore e Funkcionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i> <i>-Model flete provimi gjeneruar nga PITAGORA.</i> <i>-Model vendosje në kalendar të një eventi online TEAMS.</i> <i>-Model Statistike përdorimi të platformës TEAMS për leksion online.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Realizimi i veprimtarisë akademike të personelit akademik, sidomos veprimtaritë e kryera në territorin e UART, verifikohet nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Monitorimit në kohë reale të procesit mësimor në përputhje me Rregulloren e FM. Monitorimi i veprimtarisë artistike/shkencore në përputhje me Rregulloren e FM. <p>Gjithashtu, në rastet e realizimit të veprimtarive të tjera për të cilat stafi akademik ka nevojë për leje të veçantë, në përputhje me Rregulloren e FM, Neni. 20, pika. 11, në përfundim të aktivitetit, stafi akademik ka detyrimin e dorëzimit të dokumentacionit justifikues dhe të një raporti narrativ. Në përfundim të vitit akademik, në analizën realizuar pranë Njesisë Bazë KMDP, evidentohen problematikat që mund të jenë hasur gjatë vitit akademik..</p> <p><i>Referencë:</i></p>

	<p><i>Evidenca: Rregullore e Universitetit te Arteve Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 23.i.2.3 pdf. VSA_45 Rregullore e Departamentit, FM.</i></p>		
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ ka analizuar webin, faqen e Institucionit dhe konstaton se duke u mbështetur në Statutin e UART dhe Rregulloreve përkatëse realizon publikimin e informacioneve që lidhen me programin e studimit, me personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në faqen zyrtare të UART.</p> <p>Referencë:</p> <p>-Statuti i UART http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF</p> <p>-Informacion programi i studimit “Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” http://uart.edu.al/media/2021%20-%20FM%20PERSONEL%20AKADEMIK.pdf</p> <p>-Informacion aktivitetet të ndryshme http://uart.edu.al/index.php?pg=fq&id=1111&niveli=92</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit Pitagora, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatohet, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për</p>	<p>Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili miratohet më pas nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i mbulimit financiar për programet e studimit dhe njësinë bazë.</p>

<p>mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UART, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj.</p> <p>Projektbuxheti, parashikon të gjitha kostot e mbulimit financiar të programit të studimit dhe pasi miratohet në Senatën Akademik dhe Bordin e Administrimit, i përcillet për miratim përfundimtar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Referencë: <i>Evidenca IV.5.2: Plan buxheti i financimit të programeve të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi, përmes së cilit specifikohen shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit. Gjithashtu Njësia Bazë KMDP, në kërkesat për financim parashikon, përpos stafit akademik, parashikon edhe mbështetjen e bazës materiale, veprimtarisë shkencore-artistike të stafit akademik, veprimtarive të kryera nga studentët etj. Institucioni, bazuar në planifikimin financiar, siguron mbështetjen financiare për të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me programin e studimit.</p> <p>Referencë: <i>-Vendim SA për Plan Buxhetin e financimit të Programeve të studimit (model)</i> <i>-Vendim BA për Plan Buxhetin e financimit të Programeve të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Konstatuam që, UART, nuk i është nënshtruar një auditimi financiar, për shkak se disponon një strukturë të posaçme për realizimin e Auditit të brendshëm, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.</p> <p>Në bazë të VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në Sektorin publik”, pika 1,b. - Njësitë e auditimit krijohen në çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëri tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat</p>

	<p>kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçantë, UART nuk plotëson kushtet për të patur një Strukturë të Auditimit të brendshëm.</p> <p>Referencë: Evidenca: Nr. 2.16 VKM NR. 83, datë 03.02.2016. Evidenca: IV.5.3</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konstatohet se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatohet se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të gjitha të dhënat përsa i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera.</p> <p>Referencë: Evidenca: IV.5.4. Evidenca: Pasqyrimi financiar vjetor UART. Evidenca: Ligji nr. 10/296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UART garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program studimi nëpërmjet aplikimit në projekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Referencë: -Ligjin nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80 -Ligjin nr. 10/296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, https://infrastruktura.gov.al/ep/content/uploads/2017/10/Ligj_10296_8.7.2010.pdf</p> <p>Evidenca: Pasqyrimi financiar vjetor UART. Evidenca: Plan buxheti i financimit të programeve të studimit</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</p> <p>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UART ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Diplomimi i studentëve në programin Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi” bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Referencë: <i>Evidenca: Statuti_uart_2021.</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Universitetit te Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf: Rregullore studimi Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë që institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së ciklit të dytë Master ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p>

	<p>Politikat e UART, të materializuara në rregulloret e tij, garantojnë kushte të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrjen e shërbimeve në UART • Vlerësimin në provime • Rregjistrimin në konkurset e pranimit dhe zhvillimin e tyre • Mbrojtjen e diplomës (artistike dhe tezës me shkrim) • Promovimin artistik në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë institucionit • Pjesëmarrjen në Master-Class-e, Workshop-e, Leksione të hapura etj • Ushtimin e të drejtave të tyre sipas parashikimeve të rregullores së studimit dhe atë të programit. <p>Këto kriteret, procedurat, kërkesa për transferim dhe të gjitha rregulloret e aktet rregullative janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Arteve, si edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf, Rregullore studimi Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</i></p> <p>http://uart.edu.al/index.php http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=987&niveli=127 http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=544&niveli=142</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Rezulton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga KMDP dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi", duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Per ngritjen e komisionin e ciklit te dyte te programit te dyte.</i> <i>Evidenca: Rregullore studimi Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</i> <i>Evidenca: Rregulloret dhe kriteret 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UART, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që</p>

dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

ofron. Konstatohet që kurrrikula, e detajuara me lëndët dhe modulet që përmban program Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UART, sipas fakulteteve përkatëse:

(<http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pgçfaqe&idç5&niveliç9>)

Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:

Rregullorja e ciklit të II të studimit Master, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.

Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit.

Kurrikulën e Programit të Studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi. Rregullorja e Programit të Studimit, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.

Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik; manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.

Konstatohet se bazuar në Rregulloren e UART, në Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e ciklit të II të studimit Master si dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”

Referencë:

Evidenca: SYLABUS, Dokumenti 49/II.3.3 Syllabus Pedagogji Muzikore.PDF

Evidenca: Dokumenti 32.II.1.1 Plan mesimor. Plani mësimor Programit të Studimit Master Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”

Evidenca: Rregulloret dhe kriteret 2022-2023.

Evidenca: Rregullore e Universitetit te Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.

	<p><i>Evidenca: Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 17/ I.1.8. për Miratimin e Rregullores së Veprimitarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 36/ II.1.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Rezultoni se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi.</p> <p>Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjenden në çdo kohë plan programet për çdo program studimi: http://uart.edu.al/index.php?pgçfaqe&idç193&niveliç70</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: http://uart.edu.al/index.php?pgçfaqe&idç549&niveliç124</i> <i>Evidenca: Rregulloret dhe kriteret MASTER 2022-2023 FM.</i> <i>Evidenca: Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</i> <i>Evidenca: Dokumenti 32.II.1.1 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit që UART ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p> <p>UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Rregulloret dhe kriteret MASTER 2022-2023 FM.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 32.II.1.1 Plani mësimor I programit të Studimit Master Profesional</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (http://www.uart.edu.al/). Plani i programit të studimit i bëhet i ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UART, gjendet në çdo kohë Rregulloret dhe kriteret për pranimin e studenteve</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca:</i> http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20MASTER%202022-2023%20FM.pdf <i>Evidenca:</i> http://www.uart.edu.al/</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UART ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit romë, ballkano - egjiptianë, si dhe jep bursa për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit: http://uart.edu.al/index.php?idç1138</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - http://uart.edu.al/index.php?idç1138 - VKM Nr 780, dt. 26.12. 2018 “ Për përcaktimin e kategorive të individëve për ulje tarife” - VKM Nr. 251 dt. 27.03.2020 për një ndryshim në VKM nr. 269 dt. 29.03.2017 për përjashtimin nga pagesa të studentëve; Romë-Ballkano –Egjiptianë. 		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UART, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online në faqen zyrtare të web-it.</i> <i>Gjithashtu, konstatohet se UART, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UART, sipas fakulteteve përkatëse.</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e ciklit të II të studimit Master, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. • Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional “pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të studimit, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART. • Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester vihen në dispozicion nga lektori i lëndës. Në to janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit. <p>Referencë: <i>Evidenca: Dokumenti 32.II.1.1 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”</i> <i>Evidenca: Dokumenti 36.II.1.5.Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional”.</i> <i>Evidenca: Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të studimit Master Profesional në “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”,</i> <i>Evidenca: Dokumenti 13/I.1.3 Rregullore programi.pdf. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores se Programit të Studimit Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë</p>

	<p>për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtari mësimore, vlerësimin dhe diplomimin.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 13/1.1.3 Rregullore programi.pdf. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se bazuar në Rregulloren e UART, në Rregulloren e ciklit të II të studimit Master dhe syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Universitetit të Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i> <i>Evidenca: Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional</i> <i>Evidenca: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</i> <i>Evidenca: Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të studimit Master Profesional në Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi", janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se KMDP, në fillim të vitit të parë të studimeve në bashkëpunim me Këshillimin e Karrierës dhe Alumni, organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit të Studenteve, Keshillimit të Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>

Konkluzione	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban programi i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi", ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Konstatojmë që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Komunikim i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet sistemit Pitagora. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me format e vlerësimit për secilën lëndë, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.</p> <p><i>Evidenca: Manual - studenti në sistemin Pitagorë.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional "Pedagogji muzikore dhe Mësuesi", në të cilën përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.</p> <p>Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UART.</p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Pedagogji muzikore dhe Mësuesi".</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	<p>Konstatojmë se Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Njësia e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e</p>

XB *K*

<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p> <p><i>Evidenca: Foto nga koncerte, masterclasse, takimee etj., pdf të pedagogëve të FM, studentë aktualë dhe ALUMNI FINAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, Departamenti KMDP, në bashkëpunim me Njësinë e Karrierës dhe Alumnit, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Në faqen e internetit të UART, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pgcfaqe&idc44&niveliç3</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Konstatohet se informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet platformës Microsoft Teams dhe Pitagora, sikurse pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, nëpërmjet të cilëve ata ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor, platforma të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e procesit mësimor dhe artistik edhe gjatë periudhës së pandemisë. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë. Gjithashtu Universiteti i Arteve siguron menaxhimin e informacionit në distancë për të gjithë studentët nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) web-it të UART (http://www.uart.edu.al/) dhe rrjeteve sociale; b) Komunikimit nëpërmjet postës elektronike; <p>Sistemi të integruar PITAGORA</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Manuali i përdorimit të sistemit Microsoft Teams</i> <i>Evidenca: Manual - studenti ne sistemin Pitagorë (2).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që në faqen e internetit të UART gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UART dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, etj.</i></p>

	<p><i>Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon.</i></p> <p><i>Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.</i></p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit dhe Plani strategjik për zhvillimin e insitucionit, konstatojmë se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer. Shkëmbimi i informacionit me qëllim mbajtjen e statistikave vjetore të studentëve dhe të diplomuarve, realizohet mes Sektorit të Statistikave dhe informacionit me Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Muzikës.</p> <p>Konstatojmë, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që UART ofron, specifikisht për Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”, rezultojnë të regjistruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2019-2020 në total 24 studentë; • për vitin akademik 2020-2021 në total 27 studentë; • për vitin akademik 2021-2022 në total 29 studentë; <p>Ky informacion gjendet pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Muzikës, dhe është pjesë informacionit që ju jepet Njësive Bazë, për analizat apo çështje të tjera sipas rastit. Gjithashtu ky informacion pasqyrohet edhe në analizën vjetore të Njesisë Bazë KMD, sikurse dhe atë të Fakultetit të Muzikës.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca : Dokumenti 26.I.3.2 Urdhër Rektori për zhvillimin e analizës vjetore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca : II.3.5, Analiza vjetore të Njesisë Bazë KMD.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës, rezulton se Sekretaria</p>

<p>studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Nga vizita në institucion me përfaqësues të Njësisë së Karrierës dhe Alumnit (NjKA) konstatuam se ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Rezulton se NjKA në bashkëpunim me sektorin mësimor, bazuar edhe në Rregulloren e Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistri themelart FM - Regjistri i Arritjeve FM - Sistemi Pitagora <p><i>Evidenca: VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules. Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p> <p><i>Evidenca: Te dhenat e studenteve te diplomuar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se sekretaria mësimore e FM disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu, ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në sistemin Pitagora dhe database-n Excel që disponon.</p> <p>Referencë:</p>

	<p><i>Evidenca: Rregullore e Funkzionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p> <p><i>Evidenca: Manual - studenti ne sistemin Pitagorë (2)</i></p> <p><i>Evidenca: Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale"</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazur ne Rregulloren e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FM si dhe ne Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART rezulton se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse si sekretaritë mësimore, sektoret e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Funkzionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART.</i></p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Konstatohet se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sekretaria Mësimore gjithashtu, disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje, por këto të dhëna nuk janë paraqitur në raportin e GVB.</p> <p><i>Evidenca: Analizë vjetore Departamentit KMDP.</i></p> <p><i>Evidenca: Të dhënat e studentëve të diplomuar</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Konstatojmë që studentët e UART janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm si dhe gjithashtu janë pjesë e komisionit të marrëdhënieve me studentët, ngritur në Tetor të vitit 2021 në rang institucional.</p> <p>Senati Akademik i UART ka në përbërje 2 (dy) studentë, ndërkohë që Këshilli i Etikës, prej 5 (pesë) anëtarësh, ka në përbërje 1 (një) student. Përveç organeve të mësipërme drejtuese studentët organizohen në Këshillin e Studentëve (V.5.1 http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=98&niveli=104).</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Statuti_uart_2021.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 59/II.5.1 urdhëri për ngritjen e grupit të punës.pdf. Komunikim zyrtar shkresor per akreditimin, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Rezulton që institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NjZHKC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Statuti_uart_2021.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 59/II.5.1 urdhëri për ngritjen e grupit të punës.pdf. Komunikim zyrtar shkresor per akreditimin, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Konstatojmë se studentët janë të përfshirë në takimet e organizuara nga Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për akreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj, si dhe janë pjesë e GVB, për hartimin e RVB për Programin e Studimit Master Profesional “Pedagogji muzikore dhe Mësuesi”.</p> <p>Referencë:</p>

	<p><i>Evidenca: Komunikim zyrtar shkresor per akreditimin., Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 63.II.5.5 Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e pyetësorit të studentëve, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 63.II.5.5 Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët e UART janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës</i></p> <p><i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Konstatohet se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës. Zyra e Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni angazhohen në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. DI në bashkëpunim me zyrat e sipërcituara vënë në dispozicion të tyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do të ndjekin.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p> <p><i>Evidenca: Statuti i UART,2021</i></p> <p><i>Evidenca: Udhëzimi Nr. 27 date 29.12.2017</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UART dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim, etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet aksesit në sistemin Pitagora.</p> <p>https://uart.pitagora.rash.al/login</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Konstatojmë se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon. Gjithashtu ky sektor ofron informacion për bursa, informacion në lidhje me mobilitetet dhe programet e shkëmbimeve jashtë vendit si dhe në bashkërendim me DI orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: Uart agder 2021 agreement. Evidenca I.I.3.2.1 Uart agder 2021 agreement.</i></p> <p><i>Evidenca: Universiteti i Arteve - Statistikat ICM - shtator 2022.pdf Endra Të dhëna mbi mobilitetin e studentëve FM.</i></p> <p><i>Evidenca: Urdher-Nr.100-dt.25.2.2022-RREGULLORJA-PER-ZHVILLIMIN-E-PRAKTIKAVE-PROFESIONAL-TE-MESUESIT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Konstatojmë që Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka nisur procesin e gurmimit të studentëve pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale,</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_21, dt_07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI në UART.</i></p> <p><i>Evidenca: Statuti i UART, 2021</i></p> <p><i>Evidenca: Te Diplomuarit statistike e marre në sekretari. Studente të diplomuar (41)</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti III.1.6 aktivitete, foto e mesimdhënieve të pedagogëve në institucione të huaja.pdf; Dokumenti 64/ II.5.6 Master-Class.pdf. Aktivitetet e Stafit, Studentëve dhe Alumni të FM.</i></p>

Konkluzione	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteve të ndryshme artistike që institucioni organizon</i></p> <p><i>Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Universiteti i Arteve për vetë specifikën e programeve që ofron, ka hartuar Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës si Rregulloren e ciklit të II të studimit Master në UART ku jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojnë për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e sylabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.</p> <p>Referencë:</p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Universitetit të Arteve VSA_Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p>

	<i>Evidenca: VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë"</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>Nga vizita në institucion konstatuam se institucioni ka ngritur një komision ad-hoc për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në UART. Në këtë rregullore përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit dhe të marrëdhënieve me strukturat e tjera brenda universitetit. Disa forma që institucioni përdor për vlerësimin e performancës së universitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza vjetore e departamentit, - Analiza vjetore ne rang institucional; - Vlerësimi i mësimdhënies nga studentet. <p><i>Evidenca: Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i></p> <p><i>Evidenca: Analize vjetore KMDP.</i></p> <p><i>Evidenca: Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Spektori Mësimor & Kurrikulës është përgjegjës për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre.</p> <p>Spektori Mësimor & Kurrikulës organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët dhe i bën të ditur për stafin akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të UART. Çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që iu bëhet nga studentët.</p> <p><i>Evidenca: Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i></p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Spektori Mësimor & Kurrikulës është përgjegjës për realizimin e pyetësorëve të studentëve, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike.</p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon	<p>Rezultatet e vlerësimit, ndryshe nga praktikat e të kaluarës nuk shërbejnë si penalitete, por si modele që duhen përmirësuar dhe nxitur në mënyrë konstruktive. Ato i shërbejnë institucionit, departamenteve dhe vetë</p>

shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	pedagogëve për të qenë më aktivë në planet e zhvillimit strategjik të institucionit, programit të studimit dhe lëndëve të veçanta. <i>Evidenca: VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i> <i>Evidenca: Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART.</i>		
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka ngritur një komision ad-hoc për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në UART dhe se Sektori Mësimor & Kurrikulës organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët duke përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se institucioni ka hartuar politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UART bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Institucioni ka ngritur një Komision Ad-Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe bazuar në organigramën e UART, rezulton se institucioni ka në strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi.</p> <p>Rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë referuar, Nenit 35 të Statutit UART.</p> <p>Reference:</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 21.I.2.1 Organigrama FM Organigrama FM (2).</i></p>

	<p><i>Evidenca: Statuti_uart_2021.</i></p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni ka ngritur një Komision Ad-Hoc për Sigurimit e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.</p> <p><i>Evidenca: Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të UART". Bashkëngjitur Statuti.</i></p> <p><i>Evidenca: Urdhëri FM Nr. 01, dt. 10.03.2022, Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në FM.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet që institucioni përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë, siç janë pyetësor për studentët për matjen e cilësisë së procesit mësimor. Gjithashtu, rezultojnë se institucioni realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 63/ II.5.5 Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula..</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.2 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.3 - Analize vjetore KMDP</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni kryen sondazhe me studentët për procesin e mësimdhënies si dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën artistike si dhe mësimore-shkencore të stafit akademik, por rezultojnë se, institucioni nuk ka paraqitur evidencat që të dëshmojnë vlerësimin në mënyrë periodike të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik të FM.</p> <p>Rekomandohet ngjitja e instrumenteve matës për pasqyrimin gjendjes, arritjeve të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik si dhe hartimi i raporteve periodike për ecurinë e tyre.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 63/ II.5.5 Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula..</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.2 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.3 - Analize vjetore KMDP</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Institucioni ka në</i></p>

	<p><i>strukturë të saj njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, por është ende në proces realizimi. Ndaj, rekomandohet ngritja e NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë referuar Nenit 35 të Statutit UART.</i></p> <p><i>Gjithashtu konstatojmë që, institucioni kryen sondazhe me studentët për procesin e mësimdhënies si dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën artistike si dhe mësimore-shkencore të stafit akademik, por rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur evidenca që të dëshmojnë vlerësimin në mënyrë periodike të punës artistike-mësimore dhe shkencore të stafit akademik të FM.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxënësit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezulton se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që FM ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit, veprimtaritë artistike dhe kërkimore shkencore duke analizuar faktorët e riskut për çdo kategori.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 63/ II.5.5 Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula..</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.2 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i></p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.3 - Analize vjetore KMDP</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Strategjik të UART dhe Analiza vjetore e UART dhe DI, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën SËOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca: VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i></p>

<p>cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.2 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.3 - Analize vjetore KMDP</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Universiteti i Arteve përdor një sërë të dhënash për vlerësimin e programit të studimit dhe stafit akademik, sikurse janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorim të procesit të mësimdhënies • Vlerësim nga studentët për çdo lëndë • Rezultatet e studentëve në provime • Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit • Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës • Testimet lokale të kryera për ushtrimin e profesionit të mësuesit. • Rezultate të punimit të diplomave. <p>Spektori Mësimor, Alumnit dhe Karrierës, realizon studime periodike të punësimit të studentëve dhe ka një databazë të studentëve të punësuar. Pedagogët e jashtëm që janë edhe ekspertë të fushës gjithashtu, ftohen në takime e diskutime dhe ofrojnë ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe ecurinë e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.2 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca: Dokumenti 26.I.3.3 - Analize vjetore KMDP</i> <i>Evidenca: VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për vlerësimin stafit akademik nga studentët; 2) Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxëniet nga studentët; 3) Analizën vjetore të Fakultetit; 4) Analizën e tregut të punës për programet e studimit të cilit të dytë të studimeve në FM <p><i>Evidenca: Rezultatet pyetesor 2022 perfundimtar me vula.</i> <i>Evidenca: Analize vjetore FM.</i> <i>Evidenca: Studimi i Tregut FM me vula.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për</i></p>

	<p>shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</p> <p>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VL4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Planit Strategjik të UART, Analizën vjetore të FM si dhe Analizës së tregut të punës për programet e studimit të cilit të dytë të studimeve në FM, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 26.1.3.2 -Urdher-Rektori ANALIZA VJETORE.</i> <i>Evidenca: Dokumenti 26.1.3.3 - Analize vjetore KMDP</i> <i>Evidenca: VSA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti I/ RVB Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi</i> <i>Evidenca: Urdhri i Rektorit të UART Prof. Kastriot Çausi, me Nr. 283, datë 28.02.2022, "Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër akreditimit të programeve cikli II.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative</p>	<p>Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p>

dhe studentëve të programit të studimit.	<i>Evidenca: Dokumenti 36.II.1.5 VSA 2 Rregullorja e studimeve cikli 2 Master</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Bazuar në Rregulloren e UART, Rregulloren e Rregullore të Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës si dhe Rregulloren e këtij program studimi, rezulton se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullore të Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e programit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Universitetit të Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021</i></p>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, për vetë specifikën e tij, ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me artistë të njohur të fushave të ndryshme të artit si brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet angazhimit të tyre në procesin e mësidhënies si pedagogë me kohë të pjesshme ose si artistë të ftuar për të mbajtur master-class-e ku mund të ofrojnë eksperiencën e tyre. Gjithashtu, nëpërmjet zhvillimit të masterclass-eve me pedagogë të huaj nga institucione të arsimit të lartë simotra nga Evropa apo më gjerë, sigurohet ekspertiza e vlefshme për programin e studimit Master Profesional Pedagogji muzikore dhe Mësuesi, që kurse krahasohet metodologjia dhe propozimet e ekspertit të huaj.</p>			
Konkluzione	<p>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</p> <p><i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi VI.5	
Polltikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në	Rezulton se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë,

<p>kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UART.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pgcfaqe&idc549&niveliç124</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregullren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 15/I.1.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e programit Master Profesional dhe Mësuesi.</i></p> <p><i>Evidenca: Rregullore e Universitetit të Arteve VSA Nr.20 dt.07.10.2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Konstatojmë se në Planin Strategjik të UART është hartuar analiza për sigurimin e cilësisë e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Evidenca: Dokumenti 15/I.1.6 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme DI miratur nga Senati Akademik.</p> <p><i>Evidenca: VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit të Studenteve, Keshillimit të Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i></p> <p><i>Evidenca: VSA 36 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Evidenca: dokumenti 23.I.2.3 VSA_45 Rregullore e Departamentit KMDP</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me Sektorin Mësimor & Kurrikulës, rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotesojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.</p>




	<i>Evidenca: VSA Nr_ 21, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funksionimit Sektorit Mesimor dhe Kurrikules, Informimit te Studenteve, Keshillimit te Karrieres dhe ALUMNI ne UART.</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregullren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
	<i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

X/3 *X/2*

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”, Tiranë

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” është hartuar dhe riorganizuar sipas kërkesave ligjore në fuqi.
2. FM aplikon programe studimore të ndërtaura mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, me ngjashmëri me programe studimi evropiane.
3. Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” i formon profesionalisht studentët veçanërisht nga ana artistike, kulturore, por edhe nga ana pedagogjike përsa i përket ushtrimit në të ardhmen të profesionit të mësimdhënësit në lëndën e muzikës pranë institucioneve arsimore të ciklit të mesëm të ulët.
4. Personeli akademik që mbulon këtë program studimi përbëhet nga emra dhe personalite në fushën e muzikës dhe mësimdhënies. Ata janë shumë të kualifikuar, me tituj akademikë dhe grada shkencore, si dhe me përvojë shumë vjeçare në orkestrën e TKOB, muzikë dhome e solo, duke garantuar përmbushjen ligjore dhe suksesin e këtij programi studimor.
5. Biblioteka e UART është e vetnja bibliotekë arti në Shqipëri, e cila me fondin e saj shkencor, muzikor, artistik dhe historik, ofron për studentët një katalog shumë të pasur me vepra të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj. Pasurimi i kësaj biblioteke me Katalogun e Shtëpisë së famshme gjermane Henle Verlag ofron për studentët e Fakultetit të Muzikës, dhe në veçanti për studentët e programit MP në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, një mbështetje të madhe për zhvillimin e tyre profesional, si artistë/instrumentistë dhe mësues të ardhshëm të lëndës së muzikës.
6. Aksesimi online dhe pa pagesë i studentëve në katalogun online të BSHUA dhe në International Library Petrucci – IMSLP, lejon marrjen në formate digjitale të fondit historik dhe arkivin e këtyre bibliotekave.
7. Rastet e aplikimit në “Portalin për Mësues” të studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi” janë një tregues i suksesit të këtij programi studimi.
8. Përfshirja e studentëve në veprimtari artistike e shkencore, përkrah pedagogëve të tyre, siguron mundësi të gjëra për promovimin e studentëve përpara se ata të diplomohen.
9. Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në projekte të përbashkëta artistike, mes stafit akademik, Alumni dhe studentëve është një element shumë i rëndësishëm institucional.
10. Institucioni aplikon Masterclasses, si një formë e rëndësishme për përmirësimin e mësimdhënies, përmes njohjes së modeleve më të sukseshme të artistëve evropianë.
11. Institucioni karakterizohet nga një komunikim shumë i mirë brenda njërive përbërëse.

Pika të dobëta

1. Mundësi të pakëta mobiliteti të studentëve të programit Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi, në kuadër të projekteve ndërkombëtare Erasmus+.

Rekomandime

1. Rekomandohet që institucioni të mbështesë hartimin e një Udhëzuesi për mësimdhënien dhe të nxënët ndërveprues, ku të përfshihen praktikantët më të mira të mësimdhënies që zhvillojnë realisht pedagogët e FM në procesin mësimor, si dhe përvojat e reja të mësimdhënies që ata kanë përfituar në kuadër projektsh.
2. Rekomandohet të rishikohen disa aspekte teknike në Planin Mësimor, të lidhura kryesisht me pasqyrimin e shumës në total për orët brenda dhe jashtë auditorit, pasqyrimi ngarkesës mësimore javore në çdo semester, si dhe sasisë së orëve mësimore dedikuar leksioneve / seminareve / ushtrimeve për një lëndë/modul. Orët mësimore të praktikës mësimdhënëse të shënohen në kolonën "orë mësimore në auditor".

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Musical Pedagogy and Teacher" provided by the Higher Education Institution "University of the Arts", Tirana

Strengths and affirmations

1. The study program Professional Master in "Musical Pedagogy and the Teacher" has been designed and reorganized according to the legal requirements in force.
2. MF applies study programs built on the European Qualifications Framework, similar to European study programs.
3. The study program Professional Master in "Music Pedagogy and the Teacher" trains students professionally, especially from the artistic and cultural side, but also from the pedagogical side in terms of the future exercise of the teaching profession in the subject of music at pre-university educational institutions of the low middle cycle.
4. The academic staff covering this study program consists of names and personalities in the field of music and teaching. They are highly qualified, with academic titles and scientific degrees, as well as many years of experience in the NTOB orchestra, room music and solo, guaranteeing the legal fulfillment and success of this study program.
5. The UART library is the only art library in Albania, which with its scientific, musical, artistic and historical fund, offers students a very rich catalog of works by Albanian and foreign composers. The enrichment of this library with the Catalog of the famous German House Henle Verlag offers the students of the Faculty of Music, and in particular the students of the MP program in Music Pedagogy and Teacher, a great support for their professional development, as artists/instrumentalists and future music teacher.
6. Online and free access for students of the online catalog of BSHUA and the International Library Petrucci - IMSLP, allows the acquisition in digital formats of the historical fund and archive of these libraries.
7. The cases of applications to the "Teacher Portal" of students who graduated from the Professional Master's study program in "Musical Pedagogy and Teacher" are an indicator of the success of this study program.


8. The involvement of students in artistic and scientific activities, alongside their teachers, provides ample opportunities for promoting students before they graduate.
9. Cooperation and participation in joint artistic projects between the academic staff, alumni and students is a very important institutional element.
10. The institution applies Masterclasses, as an important form for the improvement of teaching, through the recognition of the most successful models of European artists.
11. The institution is characterized by a very good communication within the constituent units.

Weaknesses

1. Limited mobility opportunities for students of the study program "Professional Master" in "Music Pedagogy and Teacher", within the international Erasmus+ projects.

Recommendation

1. It is recommended that the institution support the drafting of a Guide for interactive teaching and learning, which includes the best teaching practices that MF pedagogues actually develop in the teaching process, as well as the new teaching experiences they have gained within projects.
2. It is recommended to revise some technical aspects in the Academic Plan, mainly related to the reflection of the total amount for the hours inside and outside the auditorium, the reflection of the weekly teaching load in each semester, as well as the amount of teaching hours dedicated to lectures / seminars / exercises for a subject/module. The teaching hours of teaching practice should be noted in the column "teaching hours in the auditorium".



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X